


**RAPORTI VJETOR I KOMISIONERIT  
PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE  
VITI 2010**



## PËRMBAJTJA

Fjala e hyrjes .....	fq 3
I. Parimet bazë të funksionimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale .....	fq 4
I.I Misioni, vizioni dhe objektivat.....	fq 4
II. Kuadri Ligjor.....	fq 4
II.I Hartimi dhe miratimi i kuadrit nënligjor .....	fq 5
II.II Dhënie mendimi mbi projekt-ligjet e projekt-aktet normative .....	fq 7
II.III Bashkëpunimin Institucional .....	fq 8
II.IV Transferimi i të dhënave personale jashtë vendit .....	fq 8
III . Ndërgjegjësimi.....	fq 9
III.I Seminare dhe trajnime .....	fq 9
III.II Ndërgjegjësimi në terren.....	fq 11
III.III Ndërgjegjësimi i grupmoshave të reja.....	fq 12
III.IV Publikime dhe shpërndarja e broshurave.....	fq 15
III.V Trajnimi i Stafit të Komisionerit.....	fq 16
III.VI Evidentime të moszbatimit korrekt të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e medias së shkruar.....	fq 17
III.VIII Komunikimi i zyrës me median.....	fq 18
IV. Njoftimi i subjekteve kontrollues.....	fq 19
IV.I Plotësimi i Formularit të njoftimit.....	fq 21
IV.II Regjistrimi i subjekteve kontrolluesve që përpunojnë të dhëna personale.....	fq 22
V. Trajtimi i ankesave.....	fq 23
V.II Hetim-Inspektimi ndaj Kontrolluesve që përpunojnë të dhëna personale.....	fq 24
V.III Vendimet administrative (gjokat) e vendosura nga KMDP.....	fq 32
VI. Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare .....	fq 33
VI.I Bashkëpunimi me Komisioni Evropian, implementimi i Projektit EU-IPA 2009 .....	fq 36
VI.II Asistenca e ekspertëve ndërkombëtarë .....	fq 37
VII. Realizimi i buxhetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale .....	fq 37
VIII. Sektori i Teknologjisë së Informacionit.....	fq 39
VIII. Synimet kryesore të punës dhe Strategjia për vitin 2011 .....	fq 39
VIII. Të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e KMDP.....	fq 41

## Fjala e hyrjes

### Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

**Flora Çabej ( Pogaçe)**

Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale i cili u krijua në bazë të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, është autoriteti që kontrollon përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj lidhur me përpunimin e të dhënave personale. Puna e institucionit është e lidhur me kontrollin e përmbushjes së rregullave ligjore që kanë për qëllim mbrojtjen e privatësisë, ndihmën për individët në rastin e ndërhyrjes në jetën e tyre private si dhe bërja e një pune këshilluese dhe konsultative. Kryerja e kontrollit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale ka përbërë dhe përbën thelbin e veprimtarisë së Komisionerit prej themelimit.

Raporti që po prezantojmë përpara Jush, shënon 2 vjet punë dhe tenton pasqyrimin e panoramës së plotë e të qartë të veprimtarisë progresive dhe gjithëpërfshirëse për arritjen e objektivave më të rëndësishëm në mbrojtjen e të dhënave. Niveli i respektimit dhe i të qenurit i informuar për sa i përket rëndësisë së lirisë së shprehjes dhe të të drejtave të mbrojtjes së privatësisë është duke u rritur çdo vit e më shumë.

Në ditët e sotme mbrojtja e të dhënave personale është ndërlikuar, dinamizuar dhe në një shkallë të caktuar në varësi të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë së informacionit, teknologjitë inteligjente e bëjnë më të lehtë jetën tonë të përditshme, por ne jemi njëkohësisht të vetëdijshëm për impaktin negativ të tyre në privatësinë tonë.

Ne duhet të bëjmë balancën midis të drejtës për informacion dhe mbrojtjes së privatësisë, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore si dhe dinjitetin, me referencë të veçantë për fshehtësinë e identitetit personal dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, duke pajtuar të drejtat themelore të personit me të drejtën e qytetarëve për informim dhe lirinë e shtypit.

Viti 2010 vazhdoi të jetë një vit sfidues në lidhje me jetën private, fushat e ndërgjegjësimit, shkeljet dhe masat e sigurisë së të dhënave personale. Nga ana tjetër, veprimtaria e këtij viti ka ndihmuar për të rritur vetëdijen e individëve për të drejtat e tyre dhe u ka dhënë atyre besimin për t'u adresuar pranë KMDP për situata në të cilat atyre u janë shkelur të drejtat në lidhje me të dhënat e tyre personale. Si rezultat, ne kemi pasur në vazhdimësi një rritje të numrit të pyetjeve dhe ankesave të paraqitura pranë zyrës sonë.

Kompleksiteti i hetimeve dhe kontrolleve të ndërmarra nga KMDP është dëshmi e zhvillimit dhe objektivave proaktive në përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale.

## **I . Parimet bazë të funksionimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

KMDP është autoriteti përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale funksionon në zbatim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i cili është në përputhje me Direktivën e BE-së 95/46 . Parimet dhe normat e veprimtarisë së KMDP-së e kanë burimin në Kushtetutën e Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare.

E drejta e lirisë së shprehjes dhe e drejta e mbrojtjes së privatësisë janë përkrahur dhe mbrojtur nga institucioni ynë. Si shtyllat themelore të demokracisë, të dy këto të drejta ndërthuren në punën e sektorit publik të Shqipërisë si dhe në jetën e përditshme të njerëzve, dhe në këtë mënyrë ato kontribuojnë në zhvillimin e ligjit.

Miratimi i ligjit për “Mbrojtjen e të dhënave personale” të Komisionerit ka mundësuar bashkëekzistencën e së drejtës së lirë të shprehjes, dhe mbrojtjen e Privatësisë. Interpretimi i koordinuar dhe një afrim i konsiderueshëm i të dy këtyre fushave ligjore është jashtëzakonisht i rëndësishëm në mbrojtjen ligjore dhe në veçanti në të qenurit i informuar që misioni i Komisionerit të jetë konform këtyre të drejtave themelore të njeriut.

### **I.I Misioni, vizioni dhe objektivat**

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ushtron veprimtarinë e tij si një institucion publik, i pavarur, i ngarkuar me detyrën për të kontrolluar përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ligji në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

Në zbatim të ligjit, pas ngritjes së autoritetit është synuar, hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore, akteve të brendshme administrative, ndërgjegjësimi i kontrolluesve publikë e privatë si dhe i subjekteve të të dhënave, përafrimi i legjislacionit të brendshëm dhe atij evropian, realizimi i njoftimeve nga kontrolluesit, trajtimi i kujdesshëm i ankesave apo kërkesave për konsulencë si dhe ajo ç’ka është më e rëndësishmja inspektimi i veprimtarisë së punës së kontrolluesve në përputhje me këtë ligj.

## **II. Kuadri Ligjor**

Në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes se Stabilizim-Asociimit, në arritjet e deritanishme të fazën që ndodhet procesi i integritit European të vendit tonë në Bashkimin European, një hap i rëndësishëm është përqasja e plotë e legjislacionit të brendshëm me atë të *Acquis Communautaire*. Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, do të vazhdojë të mbetet prioritet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Rëndësi i është kushtuar legjislacionit dytësor që është plotësuar me vendime,

udhëzime dhe rregullore të cilat janë përafruar duke marrë si referencë rregulloret, udhëzimet, vendimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian të adoptuara në legjislacionin vendas. Aktet nënligjore të hartuara dhe miratuara në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” synojnë mundësimin e interpretimit dhe lehtësimin e njohjes dhe zbatimit të këtij ligji.

## II.I Hartimi dhe miratimi i kuadrit nënligjor

Gjatë vitit të kaluar Komisioneri për Mbrojtjen e të dhënave Personale ka hartuar, miratuar dhe janë botuar e vënë në funksionim vendimet dhe udhëzimet e mëposhtme:

Vendimi Nr. 1, Datë 04/03/2010 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”.

Vendimi Nr. 2, Datë 10/03/2010 për “Përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre”. Në këtë vendim përcaktohen rregullat që duhet të respektojnë kontrolluesit për sa i përket mënyrës, qëllimit dhe afatit të mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë. Gjithashtu përcaktohen rregullat për hedhjen e të dhënave në programe kompjuterike, në baza të dhënash të ngritura dhe të përcaktuara, si dhe për krijimin e dosjeve manuale.

- ✓ Udhëzimi Nr. 1, datë 19.02.2010 për “Lejimin e disa kategorive të Transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”;
- ✓ Udhëzimi Nr. 2, datë 25.02.2010 për “Detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Hetim Inspektimit ;
- ✓ Udhëzimi Nr. 3, datë 05.03.2010 për “Sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”;
- ✓ Udhëzimi Nr. 4, datë 16.03.2010 për “Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”, në bashkëpunim me specialistët IT të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun;
- ✓ Udhëzimi Nr. 5, datë 26.05.2010 për “Rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Hetim Inspektimit ;
- ✓ Udhëzimi Nr. 7, datë 09.06.2010 për “Përpunimin e të dhënave personale në sektorin e Arsimit”;
- ✓ Udhëzimi Nr. 8, datë 31.08.2010 “Për veprime të kontrolluesit, Komiteti Shqiptar i Birësimit, përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale”;
- ✓ Udhëzimi Nr. 9, datë datë 15.09.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”.

Janë përgatitur akte të tjera mjaft të rëndësishme si:

- ✓ Amendimet mbi Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008 të cilat i janë dërguar për mendim disa Institucioneve. Për hartimin e këtyre amendimeve kanë ndihmuar studimi dhe analiza e ligjit portugez për mbrojtjen e të dhënave si dhe materiali i përgatitur për harmonizimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me Direktivën 95/46 EC të Këshillit Evropian. Aktualisht janë marrë mendimet përkatëse të institucioneve të linjës dhe në të njëjtën kohë do të rakordohet përpunimi i tyre edhe me mendimet që do jepen nga ekspertët e projektit IPA-2009, te cilët aktualisht po asistojnë zyrën, për të mundësuar finalizimin e amendimeve, rrjedhojë e të cilit do të jetë përmirësimi i dukshëm i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- ✓ Komentari i Ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, akt i cili tashmë i botuar.
- ✓ Projekt-Rregullore Tip, “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”. Kjo projekt-rregullore do të shërbejë si model për përgatitjen e rregulloreve të tilla nga ana e kontrolluesve publike dhe privatë, detyrim i cili parashikohet dhe në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- ✓ Rregullore “Për marrjen nga ana e publikut të informacionit për dokumentet zyrtare”. Kjo rregullore është hartuar dhe miratuar, në zbatim të nenit 6 të ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”
- ✓ Indeksi (Vëllimi I), në të cilin përfshihen aktet ligjore dhe nënligjore të pesë grupimeve të institucioneve, si më poshtë :
  - I. Institucione qendrore të Republikës së Shqipërisë dhe institucionet vartëse.
  - II. Institucionet e pavarura.
  - III. Institucione bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.
  - IV. Operatorët e telefonisë dhe të internetit në Republikën e Shqipërisë.
  - V. Shërbime postare në Republikën e Shqipërisë.
- ✓ Projektvendimi me Relacionin përkatës për në Këshillin e Ministrave, me anë të së cilit kërkohej lejimi i procedurave tenderuese të iniciuara nga KMDP-ja;
- ✓ Udhërrëfyesi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale për Kontrolluesit dhe Përpunuesit;
- ✓ Udhërrëfyesi i Mbrojtjes së të Dhënave Personale për Subjektet e të dhënave;
- ✓ Pyetëtori për detyrimet e kontrolluesve gjatë përpunimit të të dhënave.

## II.II Dhënie mendimi mbi projekt-ligjet dhe projekt-aktet normative

Në zbatim të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale", janë dhënë mendime dhe opinione për akte ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave, si dhe konsulenca juridike për akte të tjera administrative ardhur nga institucione të ndryshme. Gjatë vitit 2010 janë dhënë mendime kryesisht për akte të ardhura nga Ministria e Arsimit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Integritimit, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe nga disa subjekte private. Këto mendime janë dhënë për projekt/ligje, projekt/vendime, projekt/rregullore, marrëveshje bashkëpunimi dhe shkresa të ndryshme dhe në total janë 39 dhënie mendimi.

Në kuadër të përjasjes së legjislacionit vendas me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, KMDP-ja ka kryer studime të legjislacionit në disa fusha që prekin të dhënat personale dhe në disa prej tyre janë përgatitur amendime. Si të tillë përmendim: Ligjin Nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile", Ligjin Nr. 9695, datë 19.03.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit", Ligjin Nr. 8788, datë 07.05.2001, "Për Organizatat Jofitimprurëse", Ligjin Nr. 9049 datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike", Ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konflikteve të interesave në ushtrimin e funksioneve Publike", Ligjin Nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit". Një pjesë e amendimeve do të rishihen edhe me ekspertët e projektit si akte të parashikuara edhe në planin e punës së tyre, por do të përgatiten edhe të tjera të parashikuara bashkërisht për të arritur qëllimin sikurse thamë përputhjen e legjislacionit të brendshëm.

Sa i përket amendimeve të propozuara në ligjin për KSHB dhe atë të ILDKP ato janë dërguar për tu vlerësuar pranë institucioneve respektive dhe aktualisht nëpërmjet botimeve në fletore zyrtare rezulton se në ndryshimet që janë miratuar në ligjin Nr. 10358, datë 16.12.2010 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9695, datë 19.03.2007 "Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit", janë janë përfshirë disa prej sugjerimeve që ka dhënë KMDP .

Gjithashtu, janë dhënë propozime konkrete në:

- ✓ Rregulloren e Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimit;
- ✓ Rregulloren e Brendshme të D. P. Burgjeve të cilat janë përfshirë në projekt propozimin mbi disa shtesa e ndryshime në këtë akt nga Ministria e Drejtësisë, e që rezultojnë të miratuara.
- ✓ Rregulloren e Brendshme të veprimtarisë dhe funksionimit të ILDKP.

## II. III Bashkëpunimi Institucional

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e konsideron si shumë të rëndësishme bashkëpunimin me institucionet publike dhe private pasi në tërësinë e tyre këto institucione ndikojnë në përmirësimin e fushës së mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë këndvështrim, institucioni i KMDP ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet e tjera të lidhura me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë kuadër është realizuar :

- ✓ Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe Ministrisë së Drejtësisë;
- ✓ Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- ✓ Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;
- ✓ Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive.

Komisioneri bashkëpunon ngushtësisht me institucione publike në kuadër të zbatimit të akteve kombëtare apo ndërkombëtare nëpërmjet grupeve të punës. Gjatë vitit të kaluar kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Integritimit, në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit duke raportuar në mënyrë të vazhdueshme progresin e bërë, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në kuadër të Regjistrimit Elektronik të Legjislacionit të Biznesit, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Komitetin Shqiptar të Birësimit, Institutin e Statistikave dhe Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Në këtë drejtim evidentojmë :

- ✓ Hartimin dhe nënshkrimin e Kodit Etik për INSTAT, “Rregulla Etike për përpunimin e të dhënave personale nga punonjësit e INSTAT”;
- ✓ Hartimin e Projekt-Rregullores së brendshme të policisë “Për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e tyre” ;
- ✓ Hartimin e Projekt-Kodit Etik për mediet audiovizive, për pjesën e mbrojtjes së të dhënave personale, në bashkëpunim me KKRTSH, akt i cili është dërguar pranë këtij të fundit për tu shprehur lidhur me vazhdimësinë.

## II. IV Transferimi i të dhënave personale jashtë vendit

I është kushtuar rëndësi e veçantë përmbyshjes së kërkesave të paraqitura për transferim ndërkombëtar të të dhënave personale në vende me nivel të pamjaftueshëm mbrojtje. Në këtë drejtim paraprakisht me urdhërin nr. 67, datë 9./07.2010, Komisioneri ka miratuar “Formularin e aplikimit për aprovimin e Transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, nëpërmjet autorizimit të Komisionerit”.



Në rastin e transferimeve ndërkombëtare e sidomos drejt këtyre vendeve (pasi kërkesa ka pasur edhe përsa i përket sasisë së të dhënave që kërkohen të dërgohen në një vend me nivel të mjaftueshëm për të përmbushur kontrolluesi qëllimin e tij ligjor) është kërkuar informacion më i plotë së pari për të konkluduar nëse duhet të paraqitet kërkesë për Autorizim, si dhe për të verifikuar qëllimin dhe ligjshmërinë e transferimit në kuadrin e përgjithshëm të përpunimit të të dhënave, qëllimin/qëllimet primare dhe aktivitetin e kontrolluesit. Informacioni kryesisht është kërkuar për të specifikuar subjektin marrës të të dhënave, argumentimin ligjor ku mbështetet transferimi si dhe nëse ky transferim kryhet në përputhje me nenin 8/2 të ligjit, duke i kujtuar subjekteve se nëse transferimi ndërkombëtar nuk realizohet bazuar në dispozitat e nenit 8/2 të ligjit, ata duhet të paraqesin kërkesën pranë Zyrës së Komisionerit për Autorizimin e transferimit të të dhënave, bazuar në nenin 9 të Ligjit, për ato shtete që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Subjektet janë orientuar e instruktuar të plotësojnë “Formularin e Aplikimit për Autorizimin e transferimit në një shtet pa nivel të mjaftueshëm” dhe të bashkëngjitin provat që vlerësohen nga Komisioneri të cilat duhet ti referohen përpunimit, natyrës, qëllimit dhe kohëzgjatjes së transferimit, etj.

Pas trajtimit të kërkesave për autorizim, të disa kompanive private, për transferimin e të dhënave personale në një Shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, është bërë edhe plotësimi i Regjistrit përkatës. Gjatë vitit 2010 janë trajtuar katër kërkesa duke qenë të sigurt se ky numër tanimë do të rritet.

Kompanitë të cilave i janë trajtuar kërkesat për transferim janë: Europartner’s Consulting Shpk, LM Ericsson International AB me përfaqësues ligjor Tonnuci&Partners, DNA & GREY SH.P.K dhe Western Atlas International me përfaqësues ligjor Kalo& Associates. Pas trajtimit paraprak për një pjesë të tyre janë kërkuar informacione plotësuese të cilat do të merren në konsideratë për ti pajisuar ato ose jo me autorizimin përkatës apo dhënë konsulencën ligjore.

### **III . Ndërgjegjësimi**

Gjatë vitit 2010, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka dhënë një rëndësi të veçantë ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të opinionit të gjerë publik mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i publikut të gjerë është përpjekur të arrihet në disa faza të përmendura si më poshtë ;

#### **III.I Seminare dhe trajnime**

Në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave personale, nga ana e KMDP-së gjatë vitit 2010, janë organizuar një numër i gjerë aktivitetesh mbi zbatimin korrekt të Ligjit “Për Mbrojtjen e të

Dhënave Personale” dhe sensibilizimit të publikut mbi fushën e gjerë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe asaj të privatësisë.

- ✓ Në këtë kuadër, në 24 Mars u zhvillua në **Bibliotekën e qytetit të Lezhës** një seminar sensibilizues në lidhje me njohjen e Ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ku ishin ftuar kontrollues publikë dhe privatë, rreth 27 pjesëmarrës, kryesisht përfaqësues të institucioneve shtetërore rajonale dhe private të cilët ndoqën me interes tema të ndryshme në lidhje me njohjen e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtat e individit si subjekt i të dhënave, detyrimin për njoftim si dhe mbi sigurinë e informacionit si një proces i vazhdueshëm. Gjatë seminarit u shpërndanë dosje me materiale informuese dhe ndërgjegjësuese si dhe u shpërndanë kopje nga vendimet dhe udhëzimet e dala së fundmi nga Zyra e Komisionerit.
- ✓ Gjithashtu, seminarët ndërgjegjësuese vazhduan të organizoheshin edhe në qytete të tjera si në qytetin e Durrësit me datë 5 Prill 2010, në të cilin morën pjesë rreth 20 përfaqësues të institucioneve shtetërore rajonale, të cilët ndoqën me interes tema të ndryshme në lidhje me njohjen e Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtat e individit si subjekt i të dhënave, detyrimin për njoftim dhe temën mbi sigurinë e informacionit si një proces i vazhdueshëm.
- ✓ Në vazhdim, u organizua më datë 16 Prill seminari i radhës në qytetin e Elbasanit. Pjesëmarrësit ishin kryesisht përfaqësues të institucioneve shtetërore rajonale si dhe përfaqësues të bankave kryesore me aktivitet financiar në qytetin e Elbasanit. Gjatë seminarit u shpërndanë dosje me materiale informuese dhe ndërgjegjësuese si dhe u shpërndanë kopje nga vendimet dhe udhëzimet e fundit të Zyrës së Komisionerit.
- ✓ Në datën 22 Prill, KMDP organizoi në qytetin e Beratit një tjetër seminar me titull “*Mbi njohjen e ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”. Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike të Beratit si dhe përfaqësues nga sektori bankar. Temat që u trajtuan nga lektorët tanë u përqëndruan më shumë në shpjegimin e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, në njohjen me institucionin e Komisionerit si dhe në referimin mbi detyrimin ligjor për njoftim si dhe sigurinë e informacionit. Diskutimet e pjesëmarrësve u përqëndruan në përgjithësi në temat e njohjes së ligjit si dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj mbi hartimin e rregulloreve të brendshme apo kodeve të etikës me përmbajtje mbrojtjen e të dhënave personale si dhe detyrimin për njoftim.
- ✓ Ndërsa në datën 12 Nëntor, në qytetin e Kukësit u zhvillua seminari me titull “*Mbi njohjen e ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”. Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike të qytetit të Kukësit. Seminari u ndoq me shumë interes nga

pjesëmarrësit të cilët u bënë pjesë aktive e tij duke marrë pjesë në debate mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

- ✓ Në fundin e vitit 2010 dhe pikërisht në 3 Dhjetor, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, në sallën e Konferencave të kësaj ministrie, në kuadër edhe të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me këtë institucion u zhvillua një seminar ndërgjegjësues me punonjës të kësaj ministrie dhe të institucioneve të varësisë. Temat e referuara në këtë seminar ishin ajo e “Njohjes me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe rregullat për përpunimin e të Dhënave”, “ Autoriteti Mbikqyrës, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “Detyrimet ligjore të Kontrolluesve dhe Përpunuesve për të njoftuar pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe “ Siguria nuk është një produkt por një proces ” .

Duhet theksuar se në qendër të këtyre organizimeve kanë qenë referimi i temave më të rëndësishme mbi njohjen me ligjin dhe detyrimet e parashikuara në të për tu zbatuar nga të gjithë subjektet e përfshira në ligj si dhe pajisja e pjesëmarrësve me materiale ndërgjegjësuese. Gjithashtu, vlen të përmendet interesimi i pjesëmarrësve në drejtim të detyrimeve ligjore që ligji parashikon për ta, zgjidhjet që pikërisht ky ligj ofron e sjell si risi, pyetjet e shumta, diskutimet e ndryshme, kërkesat për takime të vazhdueshme bashkëpunuese, etj.

### **III. II Ndërgjegjësimi në terren**

Për të qenë sa më afër subjekteve të të dhënave personale, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka ndërmarrë disa impenjime në lidhje me ndërgjegjësimin më efikas të subjekteve të ligjit të përmendura si më poshtë;

- ✓ Punonjës të Zyrës së Komisionerit me qëllim kontaktimin e subjekteve të ligjit, organizuan një front desk të lëvizshëm pranë ambienteve të Bibliotekës Kombëtare. Gjatë këtij aktiviteti janë shpërndarë fletëpalosje të njohjes me ligjin, janë plotësuar formularë të pyetësorit nga ana e subjekteve si dhe është dhënë informacion i gjerë mbi ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe mbi aktivitetin e Zyrës së Komisionerit.
- ✓ Më pas është zhvilluar një takim tjetër sensibilizues me subjektet e ligjit në Qendrën Tregtare Univers, në Tiranë. Në këtë aktivitet u shpërndanë gjithashtu fletëpalosjeve ndërgjegjësuese, për njohjen me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe të autoritetit mbikqyrës. Pjesë e rëndësishme e aktivitetit ishte dhe zhvillimi i sondazhit të shkallës së njohjes së fushës së mbrojtjes së të dhënave personale nga ana e subjekteve të të dhënave.
- ✓ Në datën 16 dhjetor 2010, në kuadër të veprimtarive për informimin e publikut të gjerë në lidhje me temën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Privatësisë, Zyra e Komisionerit organizoi një aktivitet sensibilizues, në ambientet e Qendrës Tregtare “*Casa Italia*”. Në këtë

aktivitet morën pjesë disa punonjës të Zyrës së Komisionerit të cilët morën kontakte të drejtpërdrejta me publikun duke informuar mbi të drejtat e individit për privatësi si dhe gjithashtu shpërndanë fletëpalosje të ndryshme të përgatitura nga Zyra si, udhëzuesi për përdorimin e rrjeteve sociale online, broshura informuese mbi fushën e gjerë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtën për privatësi të individëve etj. Për të vlerësuar shkallën e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, qytetarëve si subjekte të të dhënave personale, iu ofrua dhe plotësimi i një pyetësori të përgatitur me këtë qëllim.

- ✓ Vlen për t'u përmendur interesi i publikut të pranishëm në ambientet e kësaj qendre, për t'u njohur në veçanti me të drejtën e tyre për privatësi e garantuar kjo në ligjin Nr. 9887. dt 10.03.2008 për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe mundësinë për t'iu drejtuar Zyrës së Komisionerit për t'u ankuar në lidhje me përpunimin e paligjshëm të të dhënave të tyre personale.
- ✓ Rezultatet e të gjithë pyetësorëve janë përpunuar dhe pasqyruar në faqen tonë zyrtare.

### **III. III Ndërgjegjësimi i grupmoshave të reja**

Nën një fokus të veçantë ka qenë edhe ndërgjegjësimi i grupmoshave parauniversitare mbi konceptet e privatësisë. Zyra e Komisionerit sheh si prioritare ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare e në veçanti të të rinjve për sa i përket përpunimit të drejtë të të dhënave personale dhe zhvillimit të konceptit të privatësisë. Ndërgjegjësimi i rinisë merr një rëndësi të veçantë në kohën kur aplikacionet e botës së internetit po hyjnë çdo ditë e më shumë në jetën private të individit. Në këtë kuadër, KMDP ka organizuar gjatë kësaj periudhe aktivitete ndërgjegjëse dhe sensibilizuese si me stafin akademik, ashtu dhe me studentët e universiteteve, shkollave të mesme dhe atyre 9-vjeçare.

- ✓ Në datën 25 shkurt, Zyra e Komisionerit organizoi një takim sensibilizues me nxënësit e shkollës së mesme jo publike “Inkus”. Në seminar, u trajtua tema “Rrjetet sociale - Kujdes nga efektet anësore” e cila u ndoq me shumë interes nga të pranishmit. Seminari u ndoq më pas dhe me prezantimet e një serie video filmash me temën e Privatësisë të cilat ngjallën kureshtje të thellë tek të pranishmit. Kohë e veçantë iu dedikua edhe pyetjeve të nxënësve dhe mësuesve të cilat morën përgjigjet përkatëse nga specialistët e Zyrës së Komisionerit.
- ✓ Një muaj më vonë, në datën 26 Mars, u organizua një takim sensibilizues me nxënësit e shkollës 9-vjeçare jo publike “Motrat Qirjazi”. Në seminar, u trajtua tema “Rrjetet sociale - Kujdes nga efektet anësore”. Seminari pati një kohëzgjatje rreth një orë dhe u ndoq nga një bashkëbisedim i gjatë i nxënësve me specialistët e institucionit të Komisionerit për sa i përket çështjeve teknike dhe parimore të rrjeteve sociale. Gjatë takimit u shpërndanë materiale

ndërgjegjësuere në lidhje me ngjarjet më të fundit në Britaninë e Madhe për sa i përket keqpërdorimit të rrjeteve sociale, u shpërndanë gjithashtu një sërë këshillash për prindërit dhe mësuesit si dhe fletëpalosje sensibilizuese. Ky takim sensibilizues, u arrit edhe falë bashkëpunimit me CRCA-në, një shoqatë e cila vepron në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

- ✓ Përsëri, në datën 1 prill, KMDP organizoi një takim sensibilizues me studentët dhe punonjësit e administratës së Universitetit Evropian të Tiranës. Në seminar, u trajtuan tema të ndryshme si ajo e njohjes me ligjin, detyrimi për njoftim dhe e detyrimeve të tjera të kontrolluesit. Seminari pati një kohëzgjatje rreth dy orë dhe u ndoq nga stafi administrativ i universitetit por edhe nga studentët përfaqësues të qeverisë studentore. Gjatë takimit u shpërndanë edhe materiale sensibilizuese si broshura e Njohjes me Ligjin nr 9887, Kujdesi nga keqpërdorimi i rrjeteve sociale, Banking online, etj.
- ✓ Në datën 20 maj, u organizua një takim sensibilizues me studentët e Universitetit “Luarasi”. Në seminar, u trajtuan tema të ndryshme si ajo e Njohjes me ligjin, privatësia në kohën e Internetit si dhe ajo mbi Kujdesin nga efektet anësore të përdorimit të rrjeteve sociale. Seminari pati një kohëzgjatje rreth dy orë dhe u ndoq me interes nga studentët të cilët bashkëbiseduan gjatë me specialistët e Zyrës së Komisionerit për sa i përket çështjeve teknike dhe parimore të përpunimit të të dhënave personale nga përpunues dhe kontrollues të ndryshëm. Gjithashtu, ky seminar vlerësohet si shumë i rëndësishëm sepse i dha mundësinë institucionit tonë të njohë shkallën reale të interesit të studentëve shqiptarë mbi temën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, ka nisur një bashkëpunim të ngushtë në fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në kuadër të së cilës përveç përgatitjes së udhëzimeve të përbashkëta një rol të rëndësishëm zë dhe vazhdimësia e fushatës së sensibilizimit dhe ndërgjegjësimimit të institucioneve arsimore publike siç janë shkollat 9-vjeçare, të mesme dhe të larta. Kjo fushatë ndërgjegjësuere ka të bëjë kryesisht me sensibilizimin e stafit pedagogjik dhe të psikologëve të pranishëm në shkolla, me problematikat e përpunimit të të dhënave personale si dhe me sensibilizimin e tyre ndaj kujdesit për mbrojtjen e privatësisë e në mënyrë të veçantë tek nxënësit.

- ✓ Në këtë këndvështrim, më datat 25 dhe 26 Maj, KMDP organizoi një cikël seminaresh respektivisht pranë Drejtorisë Arsimore me praninë e psikologëve të shkollave publike 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit të Tiranës dhe në Hotel “Doro” me Drejtuesit e shkollave publike 9-vjeçare dhe të mesme po të qytetit të Tiranës. Seminarët sensibilizues me Psikologët dhe Drejtuesit e shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme synuan edhe ndërgjegjësimin për sa i përket rolit të tyre si kontrollues të të dhënave personale dhe

problematikave të shfaqura nga subjektet e të dhënave veçanërisht për sa i përket një kategorie të veçantë siç është ajo e nxënësve dhe studentëve. Gjatë këtyre seminareve u shpërndanë materiale sensibilizuese si, Broshura e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Fletëpalosjet; “Banking Online”, “Si të ankohe mi pranë Zyrës së Komisionerit”, “Kujdes nga përdorimi jo i rregullt i Rrjeteve sociale”, “Paketa e Këshillave mbi përdorimin e rrjeteve sociale” si dhe Udhëzimi i përgatitur nga Zyra e Komisionerit “ Mbi marrjen e masave të sigurisë së të dhënave Personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”.

- ✓ Në vazhden e bashkëpunimit me stafin pedagogjik dhe të psikologëve të pranishëm në shkollat publike, KMDP pati mundësinë të realizonte në muajin tetor një aktivitet sensibilizues me nxënësit e shkollës së mesme “Aleks Buda”. Gjatë këtij aktiviteti u fol për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Privatësisë si dhe kujdesit që duhet patur gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Gjatë aktivitetit janë shpërndarë fletëpalosje të ndryshme në lidhje me fushën e gjerë të të dhënave personale dhe konceptet e Privatësisë.
- ✓ Gjithashtu, po në muajin tetor është realizuar një aktivitet sensibilizues me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “28 Nëntori”. Gjatë këtij aktiviteti u fol sërish për temën e mbrojtjes së të dhënave personale, të privatësisë si dhe kujdesit që duhet treguar gjatë përdorimit të rrjeteve sociale. Gjatë aktivitetit u shpërndanë disa fletëpalosje si dhe është realizuar plotësimi i një pyetësori në lidhje me përdorimin e rrjeteve sociale nga nxënësit e grupmoshës 10 deri në 16 vjeç. Rezultatet e këtij pyetësori janë pasqyruar në faqen zyrtare të institucionit.
- ✓ Në vazhden e ndërgjegjësimit që ka ndërmarrë KMDP për nxënësit e shkollave 9 vjeçare dhe të mesme, më datën 17 dhe 22 dhjetor 2010, u organizuan dy takime pranë shkollës 9 vjeçare “Dora d’Istria”. Takimi i parë u organizua me prindërit e nxënësve të klasave të nënta të cilët pasi u informuan nga psikologu i shkollës mbi shqetësime të caktuara, u prezantuan dhe me institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe me problematikën e mbrojtjes së privatësisë tek moshat e reja.
- ✓ Takimi i dytë u zhvillua me klasat e nënta të kësaj shkolle. Meqenëse nxënësit e këtyre moshave janë përdorues të rregullt të rrjeteve sociale, për pasojë edhe mundësia e përhapjes pa kriter të të dhënave personale është e lartë. Për të mund të evituar këtë fenomen, është parë e nevojshme që nxënësit të ndërgjegjësohen mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si dhe nga efektet anësore që mund të ketë përdorimi i këtyre rrjeteve sociale. Nga ana e punonjësve tanë u mbajtën disa prezantime mbi këto tema dhe më pas u bashkëbisedua me nxënësit për çështje të cilat ata vetë i konsideronin si të paqarta. Gjithashtu u shpërndanë edhe një set broshurash të përgatitura nga stafi i Zyrës së Komisionerit në të cilat përfshiheshin edhe këshilla për prindërit dhe mësuesit. Gjatë këtij takimi, u ofrua edhe plotësimi i një pyetësori të përgatitur nga ana e Zyrës së Komisionerit, për të vlerësuar

shkallën e përdorimit të rrjeteve sociale dhe njohjen e politikave të privatësisë gjatë përdorimit të tyre nga ana e kësaj grupmoshe.

Gjithashtu, me qëllim realizimin sa më të efektshëm të një procesi ndërgjegjësimit të grupmoshës 10 deri në 16 vjeç, KMDP ka realizuar një “*concept paper*” në lidhje me krijimin e një draft projekti për ndërgjegjësimin e kësaj grupmoshe për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky “*concept paper*” është realizuar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze dhe është paraqitur pranë Unicef për miratim.

### III.IV Publikime dhe shpërndarja e broshurave

Siç është përmendur edhe më sipër, në funksion të të gjithë aktiviteteve të zhvilluara, fushata e gjerë sensibilizuese është karakterizuar edhe nga shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuere. Për hartimin dhe botimin e këtyre broshurave e fletëpalosjeve stafi ynë ka treguar impenjim maksimal. Më konkretisht;

- ✓ Është publikuar dhe shpërndarë fletëpalosja “Mbrojtja e të Dhënave Personale, ku qëndron Problemi ?” Kjo fletëpalosje i drejtohet grupmoshës 12 deri në 17 vjeç dhe ndjek një grafikë rinore nëpërmjet të cilës arrin të zërthejë pikat kryesore të të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale tek kjo moshë.
- ✓ Një botim tjetër i rëndësishëm ka qenë dhe kalendari për vitin 2011 me pikturat më të zgjedhura të realizuara nga fëmijët të aktivitetit të realizuar me rastin e 28 Janarit Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale në “ Fshatrat SOS të Shqipërisë, Shkolla Hermann Gmeiner”. Gjithashtu pikturat më të bukura dhe më domethënëse të fëmijëve të “Fshatit SOS, Shkolla Hermann Gmeiner” të cilat u realizuan me rastin e 28 Janarit, janë ekspozuar në ambientet e Zyrës së Komisionerit.
- ✓ Është publikuar fletëpalosja “Duke Mbrojtur Privatësinë online të Fëmijëve”. Kjo fletëpalosje i drejtohet prindërve me disa këshilla se çka mund të bëjnë ata për të mbrojtur fëmijët e tyre kur janë duke lundruar në internet.
- ✓ Gjithashtu, në ambientet e institucionit tonë është krijuar dhe këndi fotografik i historikut të Institucionit.

### III.V Trajnimi i Stafit të Komisionerit

KMDP synon vazhdimisht trajnimin e stafit të saj nëpërmjet realizimit të seminareve të brendshme, njohjes me rubrikën e lajmeve javore apo përkthimeve të materialeve më të rëndësishme nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale, etj.

Në këtë drejtim, KMDP ka realizuar dy seminare të brendshme me temën “Privatësia në kohën e Internetit” si dhe “Pasaportat Biometrike”, ku janë trajtuar të rejtat më të fundit mbi këto tema.

- ✓ Në seminarin e parë janë paraqitur rastet konkrete të rrezikut të shkeljes së privatësisë nga faqet më të njohura të internetit por edhe ato më të panjohurat të cilat pikërisht për këtë motiv përbëjnë një rrezik potencial të shtuar për privatësinë e personave të cilët e përdorin këtë instrument të ri teknologjik.
- ✓ Ndërsa, në seminarin e dytë është referuar mbi historikun e dokumenteve të identitetit që në fillimet e shtetit shqiptar si dhe rruga e kryer deri në prodhimin e pasaportës biometrike sipas standarteve më të larta europiane. Është vënë theksi mbi ato dokumente të cilat cilësohen si dokumente udhëtimi si dhe përkufizimet mbi termat: **“Identitet”**, **“Dokument Identiteti”** apo **“Dokument Udhëtimi”**. Gjithashtu, është referuar në mënyrë të hollësishme për elementët teknikë të cilët karakterizojnë pasaportën biometrike.

Po ashtu e përjavshme është dhe rubrika “Lajmet e Javës” e cila dërgohet në formën e një newsletter pranë të gjithë punonjësve të institucionit. Lajmet e javës i përkasin një segmenti të gjatë informacioni i cili përshkon fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Kështu, janë përcjellë informacione të ndryshme në lidhje me vendimet e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, problematikat e privatësisë të shkaktuara nga përdorimi jo konform i teknologjisë së fundit të telefonisë celulare, ndryshimet e politikave të privatësisë në rrjetet sociale etj.

#### **Biblioteka si një formim profesional**

Biblioteka e institucionit ofron formim profesional për punonjësit e tij. Gjithashtu, ajo shërben vazhdimisht edhe për ndërgjegjësimin e nxënësve të shkollave të mesme dhe universiteteve. Biblioteka zgjeron në mënyrë të vazhdueshme koleksionin, numrin e publikimeve të saj nëpërmjet artikujve të rëndësishëm mbi temat aktuale të mbrojtjes së të dhënave personale të cilat bëhen subjekt i specializimit të inspektorëve dhe punonjësve të KMDP-së në përgjithësi. Artikujt janë mbledhur nga revista ndërkombëtare “Privacy Laws and Business” në të cilën jemi abonuar si dhe nga materiale të tjera që trajtonë këtë fushë të publikuara në faqet zyrtare të institucioneve homologe. Së fundi, biblioteka është pasuruar me përkthimet nga italishtja të dy librave të autorit të njohur italian Mauro Paissan me tituj;



- “Privatësia ka vdekur, Rroftë Privatësia” dhe,
- “Privatësia dhe Gazetaria”,

me përkthimet,

- në lidhje me mbledhjen e paligjshme të të dhënave personale nga ana e dy kolosëve të teknologjisë si Google dhe Apple,
- mbi vendimin e fundit të Parlamentit Evropian në lidhje me transferimin e të dhënave personale financiare nga Evropa në SHBA,
- mbi përplasjet e Senatit Amerikan në lidhje me qasjen mbi privatësinë si dhe
- mbi sigurinë e profileve në Facebook, etj.

Disa prej këtyre artikujve janë publikuar edhe në faqen tonë zyrtare.

### **III.VI Evidentime të moszbatimit korrekt të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e medias së shkruar**

Institucioni i Komisionerit ka ndjekur dhe ndjek me vëmendje zhvillimet e shtypit të shkruar nëpërmjet leximit dhe evidentimit të artikujve, për ti konkretizuar ato në përputhje ose jo me kërkesat e ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Gjatë punës sonë hera herës janë evidentuar disa raste të mos zbatimit korrekt të ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe akteve nënligjore të tij, nga ana e shtypit të shkruar në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, dhe konkretisht:

- ✓ Është konstatuar se nga kontrolluesit Gazeta Shqiptare, Gazeta Panorama, Gazeta Shqip dhe Gazeta Standard janë publikuar në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale identiteti dhe foto të fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes së tyre në rastet e dhunimit të tyre, veprime këto që i përkasin përpunimit jo të ligjshëm të të dhënave personale.
- ✓ Është konstatuar se nga kontrolluesit Gazeta Panorama dhe Gazeta Shqiptare janë publikuar të dhëna sensitive e konkretisht të dhëna shëndetësore të subjektit të të dhënave të përfshirë në kronikë, në një kohë që ligji për mbrojtjen e të dhënave personale i kushton rëndësi të veçantë përpunimit, mbrojtjes dhe përhapjes së këtyre të dhënave.

Në këtë drejtim për të qenë rigoroz në zbatimin e ligjit si dhe me qëllim marrjen e masave të shpejta për mospërsëritjen në të ardhmen të këtyre shkeljeve për të cilat ligji për mbrojtjen e të dhënave personale parashikon paraprakisht dhënien e rekomandimeve nga Komisioneri, janë miratuar prej tij dhe më pas janë dërguar pranë Kontrolluesve Gazeta Shqiptare, Gazeta

Panorama, Gazeta Shqip dhe Gazeta Standard rekomandimet përkatëse duke evidentuar në to, masat që duhen marrë me qëllim respektimin që duhet të bëjë shtypi i shkruar gjatë raportimit të një fakti i cili ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat e individit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rekomandimet kanë synuar qartësimin e kontrolluesve që në veprimtarinë e punës së tyre të përmbushin qëllimin për të cilin mbledhin dhe përpunojnë të dhënat personale por, pa shkelur të drejtat themelore të subjektit duke garantuar kështu, përpunimin e ligjshëm të të dhënave dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private, në fushën e gazetarisë.

Në rastet e evidentuara është orientuar marrja në konsideratë e balancimit midis lirisë së informacionit në njërin anë dhe në tjetrën, respektimi i dinjitetit dhe të drejtave themelore të çdo qytetari.

Është e njohur tanimë se, legjislacioni evropian dhe kombëtar është i bazuar në përputhshmërinë mes lirisë së lajmeve dhe të drejtave të qytetarëve (subjekt i lajmeve dhe qytetarit lexues, shikues apo dëgjues).

Këto hapa të ndërmarrë, në të vërtetë, janë një mbrojtje më e madhe për qytetarët dhe ofrojnë nxitje të reja për gazetarinë për të qenë më të vëmendshëm, më të ndjeshëm, më pak cinikë.

Gjithashtu, risi e punës sonë, dhe tashmë e pranishme, me hyrjen në fuqi të ligjit dhe veprimtarisë së KMDP-së, është ndjeshmëria gjithnjë e në rritje e shoqërisë për mbrojtjen e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit të tyre si dhe respektimi i dinjitetit të personit në mjetet e informacionit.

### **III. VII Komunikimi i zyrës me median**

Më datën 9 Prill, pranë KMDP-së, u mbajt një takim me gazetarët e shtypit të shkruar të cilët u ftuan për njohje dhe bashkëbisedim reciprok në lidhje me problematikat e ndryshme me të cilat përballen sot Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë takim pasi disa nga drejtuesit e Zyrës së Komisionerit kryen një prezantim të shkurtër rreth Ligjit, Autoritetit Mbikëqyrës si dhe rreth detyrimit për njoftim të parashikuar në ligj u vazhdua me një bashkëbisedim midis gazetarëve të medias së shkruar dhe përfaqësuesve të institucionit rreth një sërë temash në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë. Temat ishin nga më të ndryshmet duke filluar nga procesi i sensibilizimit të publikut të gjerë në lidhje me privatësinë, tek njohja me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe zbatimi i tij si dhe u diskutua mbi ndërgjegjësimin e institucioneve publike dhe private në lidhje me detyrim ligjor të njoftimit, të përpunimit të të dhënave personale nga këto institucione si dhe tema të tjera.

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson kontributin e madh që mund të japë media në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe në këtë drejtim ka treguar gjithmonë gatishmëri në dhënien e intervistave për shtypin e shkruar ashtu edhe për median vizive.

Mund të përmendet këtu intervista në emisionin televiziv “7 herë 7” në Televizionin Publik Shqiptar, intervista mbi Privatësinë në Televizionin Planet, intervista e dhënë në kronikën speciale për rubrikën Fokus gjatë edicionit të Lajmeve të Televizionit Kombëtar Klan në Maj 2010, si dhe pjesëmarrja e veçantë në televizionin Planet në 17 qershor në të cilën Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale bisedoi gjatë në studion e këtij televizioni në lidhje me temat e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Në vazhden e promovimit të institucionit në media vizive, në datën 15 Nëntor, Zyra e Komisionerit me përfaqësues Drejtorin e Marrëdhënieve me Publikun, Drejtorin e Regjistrimit, Drejtorin e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Specialistin e Marrëdhënieve me Publikun ishin të ftuar në emisionin “Zig Zag” të Televizionit Publik Shqiptar, ku prezantuan në rreth 60 minuta Institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, fushën e mbrojtjes së të Dhënave Personale si dhe u diskutua gjithashtu edhe për të drejtën e subjekteve të të dhënave për t’u ankuar pranë institucionit të Komisionerit.

Pas një bashkëpunimi me OSBE-në, është mundësuar nga kjo e fundit përgatitja e dy spoteve televizive të cilat do të shërbenin për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë mbi fushën e privatësisë dhe të mbrojtjes së të dhënave personale. Pas një bashkëpunimi që patëm me TVSH-në, është mundësuar transmetimi i këtyre spoteve në ekranin e Televizionit Publik Shqiptar.

Nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al) janë publikuar disa Njoftime për Shtyp të dala nga KMDP siç janë njoftime mbi vendosjen e gjobave administrative për kontrollues të ndryshëm, njoftime për akreditimet ndërkombëtare të institucionit të Komisionerit, pjesëmarrje në Konferenca ndërkombëtare, etj. Këto njoftime për shtyp u janë dërguar gjithashtu të gjitha mediave në rrugë elektronike me qëllim bërjen me dije të mbarë publikut të gjerë.

Sërish në funksion të familjarizimit të publikut të gjerë me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe atë të privatësisë, nga ana e stafit të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun janë botuar disa artikuj mbi privatësinë tek disa nga të përditshmet e shtypit të shkruar si Gazeta Standard apo Gazeta Metropol, etj.

#### **IV. Njoftimi i subjekteve kontrollues**

Në fillim të vitit 2010 prioritet i punës së KMDP-së ishte sensibilizimi i subjekteve kontrolluese, njohja me ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe

zbatimi i detyrimit të tyre ligjor për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për gjendjen e përpunimit të të dhënave personale. Kjo strategji e drejtpërdrejtë kërkonte informacionin e duhur për të evidentuar kontrolluesit që operojnë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, kryesisht adresën dhe emërtesën e tyre juridike. Dy ishin institucionet publike për të cilat u vendos që t'ju kërkohej asistenca në kuadrin e sensibilizimit direkt të kontrolluesve privatë dhe për të na vënë në dispozicion listat e tyre. Në këtë kuadër u jemi drejtuar me kërkesë zyrtare të Komisionerit, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Pas korrespondencës përkatëse dhe negociatave intensive më datë 03.05.2010 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet QKR dhe KMDP, ku ndër të tjera, përcaktohet vënia në dispozicion e listave të subjekteve të regjistruara pranë QKR-së, si dhe informimi i vazhdueshëm i subjekteve që regjistrohen rishtazi pranë tij, nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare të QKR-së mbi detyrimin për njoftim, linkut me faqen zyrtare të KMDP-së dhe duke ju shpërndarë fletëpalosje dhe formularë njoftimi pranë sporteleve të saj.

Përsa i përket kontrolluesve të sektorit publik është komunikuar me shkresa zyrtare të gjithë ministrive të linjës, institucioneve në varësinë e tyre, si dhe institucioneve të pavarura, është kërkuar bashkëpunim për plotësimin e këtij detyrimi ligjor. Si pasojë e kësaj strategjie sot menaxhohen në vazhdim dhe janë regjistruar një sërë institucionesh publike.

Po në këtë kuadër bashkëpunimi, pas hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe negociatave paraprake, Zyra e Komisionerit e ripunoi tekstin e këtij projekt-akti bazuar edhe në sugjerimet e palës tjetër. Teksti, i shoqëruar edhe me Relacionin shpjegues ju dërgua zyrtarisht palës tjetër. Kjo marrëveshje u nënshkrua më datë 25.01.2011 dhe menjëherë ka filluar zbatimin e saj, efektet e të cilës pritet të shtrihen përgjatë vitit 2011 e më tej. KMDP është e bindur në efektet që do të ketë zbatimi i kësaj marrëveshje administrative në rritjen e numrit të njoftimeve nëpërmjet mënyrave sensibilizuese të parashikuara dhe nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë Rajonale.

Gjithashtu, për sektorin publik të kontrolluesve, kryesisht për institucionet e varësisë, institucioneve të pushtetit vendor, si dhe ente të tjera publike, KMDP e bazoi procesin e njoftimit në informacionin që përmban lista e bërë publike në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimeve Publike. Komunikimi i drejtpërdrejtë me këto ente publike ka sjellë reagime të menjëhershme dhe pozitive në rritjen e numrit të përgjithshëm të njoftimeve.

Po ashtu, pjesë e strategjisë informuese dhe sensibilizuese ka qenë edhe fokusimi në sektorë të veçantë ku mblidhen e përpunohen shumë të dhëna personale, si shëndetësia, telekomunikacioni, arsimit dhe sistemi bankar. Për disa nga kontrolluesit që i përkasin këtyre sektorëve Drejtoria e Regjistrimit vendosi kontakte të drejtpërdrejta nëpërmjet shkresave, postës elektronike (e-mail) dhe komunikimeve telefonike, për një pjesë tjetër u ideua dhe u zbatua "skema pemë", duke patur edhe asistencën e Drejtorive Rajonale të Arsimit dhe të Shëndetësisë të shtrira në të gjithë

territorin. Këto institucione ekzekutive publike u angazhuan dhe realizuan sensibilizimin e kontrolluesve publik dhe privat të fushave që mbulojnë, çka rriti ndjeshëm numrin e njoftimeve të kontrolluesve të sektorit të shëndetësisë dhe arsimit.

Përsa i përket sektorit të telekomunikacionit, subjekteve kontrolluese, si operatorë që ofrojnë këtë lloj shërbimi, ju komunikua ky detyrim ligjor, kryesisht nëpërmjet postës elektronike dhe shkresave mbi bazën e informacionit të publikuar në Regjistrin e Sipërmarrësve, në faqen zyrtare të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Duke marrë në konsideratë eksperiencën e krijuar nga njoftimet e para, në vijim të diskutimeve të përbashkëta, KMDP konkludoi dhe hartoi disa ndryshime në përmbajtjen e Formularit të Njoftimit. Ndryshimet në Formularin e Njoftimit u miratuan me Urdhrin e Komisionerit Nr. 44, datë 07.05.2010. Këto ndryshime synonin të thjeshtonin dhe të orientonin më tej kontrolluesit që njoftojnë, si nga përmbajtja e opsioneve për tu zgjedhur në formular, ashtu edhe në plotësimin e saktë duke realizuar lidhjet logjike e ligjore ndërmjet rubrikave të formularit. Ky ndryshim u shoqërua edhe me ndryshime në Udhëzuesin “Si të plotësojmë Formularin e Njoftimit”.

#### **IV. I Plotësimi dhe shqyrtimi i Formularit të Njoftimit**

Përsa më sipër, në vijim të strategjisë së KMDP-së për identifikimin e subjekteve kontrolluese private nëpërmjet Listës së Personave Juridik dhe Fizik të Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit dhe QKR-së, janë dërguar rreth 4823 shkresa zyrtare sensibilizuese drejtuar subjekteve kontrolluese private, ndërsa sektorit publik 1044, duke i kërkuar plotësimin e detyrimit për njoftim, bazuar në Nenet 21-26 të Ligjit.

Gjithashtu, bazuar në këtë marrëveshje pranë zyrave të QKR-së janë dërguar rreth 700 Formularë Njoftimi, Udhëzime për Plotësimin e Formularit të Njoftimit dhe Fletëpalosje Sensibilizuese të cilat shpërndahen nga nëpunësit e kësaj qendre për subjekte të rinj që regjistrohen pranë saj.

Prioritet dhe objektiv tjetër i arritur mund të përmendet edhe asistencë e vazhdueshme që i është ofruar kontrolluesve që njoftojnë, me qëllim plotësimin sa më të saktë të formularit të njoftimit. Kjo asistencë ju është ofruar nëpërmjet komunikimeve telefonike dhe postës elektronike me rreth 1480 subjekte që kanë telefonuar pranë zyrave tona dhe duke i pritur përfaqësuesit e këtyre kontrolluesve pranë KMDP-së me rreth 230 takime me subjekte kontrollues. Vërehet një përqindje më e lartë saktësie në deklaram nga ata kontrollues që e kërkojnë këtë asistencë.

Bazuar në nenin 23 të ligjit, KMDP ka trajtuar nëpërmjet kërkesës për informacion plotësues çdo deklaram që ka rezultuar i paplotë, i paqartë, si dhe për të verifikuar më tej ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave nga kontrollues deklarues, si dhe në kuadrin e kontrollit paraprak në rastet e verifikimit të domosdoshmërisë ligjore për paraqitjen e kërkesave për autorizimin e Komisionerit për përpunimin e të dhënave sensitive dhe transferimin ndërkombëtar të të dhënave

personale. Numri i informacioneve të kërkuara pas deklarimeve për vitin 2010 është 675 dhe numri i informacioneve të marra nga kontrollues të ndryshëm është 449.

Në zbatim të Nenit 23, 24 dhe 32 të ligjit nga KMDP është kërkuar informacion plotësues e saktësues me anën e shkresave zyrtare dhe e-mail. Në zbatim të këtyre dispozitave të ligjit, bazuar në njoftimet e ardhura nëpërmjet Formularit të Njoftimeve, është treguar vëmendje e veçantë për subjektet që përpunojnë të dhëna sensitive, që përpunojnë të dhëna nëpërmjet CCTV (kamera të vëzhgim-regjistrimit) si dhe për rastet e transferimeve ndërkombëtare.

Në rastin e të dhënave sensitive është kërkuar informacion shtesë me qëllim për të saktësuar këtë përpunim, bazën ligjore ku mbështetet përpunimi dhe kohën e ruajtjes së të dhënave sensitive. Së pari ky informacion ka shërbyer për të kuptuar nëse përpunimi i kësaj kategorie realizohet bazuar në nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit dhe nëse ky përpunim kërkon autorizim bazuar në nenin 24 të ligjit.

Në lidhje me përpunimin përmes kamerave të vëzhgim-regjistrimi (CCTV) vëmendje i është kushtuar faktit nëse kamerat janë thjesht vëzhgimi apo edhe regjistrimi, për çfarë qëllimi janë përdorur si dhe për sa kohë ruhen këto të dhëna, për të konkluduar në ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave me faktorë të veçantë fizik, në përputhje me nenet 5 dhe 6 të ligjit.

Gjithashtu, në sajë të deklarimeve mbi kohën e ruajtjes së të dhënave, parashtruar nga kontrolluesit në informacionet plotësuese, u përgatit dhe menaxhohet një informacion statistikor mbi kohën e ruajtjes së të dhënave sensitive dhe i të dhënave të përpunuara me anën e CCTV-ve në sektorë të ndryshëm. Ky informacion mund të kontribuojë në përgatitjen dhe hartimin e akteve të ndryshme, si dhe për informacion të përgjithshëm për sektorë të veçantë që iu përkasin kontrolluesve që mund të inspektohen.

Me qëllim rritjen e numrit të njoftimeve, por edhe për zbatimin sa më rigoroz të ligjit kur dispozita të tij shkelen, Drejtoria e Regjistrimit ka informuar rregullisht Drejtorinë e Inspektimit për subjektet të cilëve iu është dërguar shkresë zyrtare dhe të cilët nuk kanë njoftuar brenda afateve të vendosura, duke mos plotësuar detyrimin për njoftim, si dhe për subjektet të cilat nuk kanë plotësuar e saktësuar informacionin e deklaruar, çka përbën kundërvajtje administrative. Për të gjithë rastet, trajtohen më poshtë masat dhe vendimmarrjet e Komisionerit.

#### **IV. II Regjistrimi i subjekteve kontrollues që përpunojnë të dhëna personale**

Pas përfundimit të shqyrtimit administrativ të deklarimeve nëpërmjet formularit të njoftimit, plotësimin të deklarimit nëpërmjet informacionit plotësues dhe shqyrtimit të ligjshmërisë së përpunimit dhe ‘kontrollit paraprak’, Zyra e Komisionerit ka vijuar me regjistrimin e subjekteve kontrolluese për njoftimet që rezultojnë dhe deklarojnë se respektojnë përpunimin e të dhënave personale konform kërkesave të neneve 5 dhe 6 të Ligjit, pra publikimin *online* në Regjistrin e Subjekteve Kontrolluese, i cili është i Hapur për Publikun

Si përfundim mund të konkludojmë se, strategjia e ndjekur nga KMDP nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë se procesi i njoftim regjistrimit ka vetëm një vit që zbatohet pas hyrjes në fuqi të ligjit, ka qenë pozitiv dhe efektiv. Kjo strategji jo vetëm që plotësoi dhe ngriti Regjistrin e Subjekteve Kontrolluese me një numër të konsiderueshëm njoftimesh dhe regjistrimesh për publikun e gjerë, por edhe vetë kontrolluesit u informuan për ligjin, institucionin dhe kompetencat e tij si dhe mbi parimet e përgjithshme të përpunimit të të dhënave personale.

Tashmë, subjektet e të dhënave, individët dhe publiku i gjerë ka informacion mbi gjendjen e përpunimit të të dhënave personale për rreth 1000 subjekte kontrolluese, informacion i cili do të kontribuojë në ezaurimin e të drejtave të tyre pranë kontrolluesve, si dhe për të realizuar ankimimin pranë KMDP-së.

KMDP ka qenë tërësisht i përkushtuar për të realizuar objektivin e përcaktuar në strategjinë e vitit 2010 dhe e ka kryer atë objektiv modest, duke menaxhuar maksimalisht informacionin e ardhur nëpërmjet formularëve të njoftimit, shqyrtimin ligjor të deklarimeve dhe evidentimin e rasteve për verifikim dhe rasteve që përbejnë kundërvajtje administrative. Eksperienca një vjeçare tashmë që KMDP ka në menaxhimin e këtij procesi administrativ dhe kompleks do të shërbejë më së miri në përcaktimin dhe realizimin e objektivave për vitin 2011.

## **V. Trajtimi i ankesave**

KMDP gjatë vitit 2010 ka marrë në shqyrtim të gjitha ankesat e subjekteve të të dhënave personale, të bëra pranë tij. Ankesat janë drejtuar nëpërmjet telefonit, në rrugë elektronike, si dhe kërkesa ankimore me shkrim. Në mbi 50 raste ankesash i ka trajtuar ato duke dhënë sqarime dhe orientuar subjektet e të dhënave personale nëpërmjet telefonit, pasi këto ankesa nuk përbënin bazë për fillim të procedimeve administrative.

Në 13 raste KMDP ka marrë ankesa me shkrim nga subjekte të të dhënave personale, të cilat i janë nënshtruar procedurave të trajtimit administrativ. Gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave ka lindur e nevojshme dhe bërja e verifikimeve pranë kontrolluesve të tillë si Zyra e Gjendjes Civile Shkodër, Zyrat e Gjendjes Civile Tiranë, SAMT pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, Drejtoria Rajonale Arsimore, Tiranë etj. Të gjitha këto verifikime janë bërë mbi bazën e urdhërave të Komisionerit për fillimin e hetimeve administrative.

Në shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave janë zbatuar me rigorozitet të gjitha parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.

Në disa raste trajtimi dhe zgjidhja e ankesave është konsultuar dhe me ekspertë të Këshillit të Evropës që na asistojnë, si dhe është marrë eksperienca e zyrave homologe për raste të ngjashme.

Natyra dhe problematika e ankesave të subjekteve të të dhënave personale që i janë drejtuar KMDP-së lidhet me përditësimin e të dhënave personale nga ana e kontrolluesve, korrigjimin e të dhënave personale, publikimin e të dhënave personale, me ngritjen e profileve të reja në rrjetin social Facebook, etj.

### V.I Hetim-Inspektimi ndaj Kontrolluesve që përpunojnë të dhëna personale

Gjatë vitit 2010 KMDP ka kryer inspektime dhe kontrole brenda kompetencave të saj në kufijtë që i ka përcaktuar ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, për të parë zbatimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesi ose përpunuesit të caktuar si të përshtatshëm.

Për përmbushjen e këtij qëllimi, titullarja e institucionit ka urdhëruar për kryerjen e inspektimeve dhe kontroleve, inspektorët përkatës për të kryer kontrole të caktuara lidhur me një subjekt specifik.

Për vitin 2010 janë nxjerrë gjithsej 19 urdhëra, nëpërmjet të cilëve inspektorët kontrolluan ligjshmërinë e mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve mbi ankesat e tyre apo për raste të kontroleve të programuara, që kishin lidhje me kontrolluesit në vazhdim:

1. Është realizuar inspektimi administrativ pranë **Televizionit Kombëtar Klan** në lidhje me rastin e publikimit në emisionin “Njerëz të humbur” (emision i llojit investigativ) të të dhënave të ankueses me cilësinë e birësueses dhe të birësuarit të saj pa marrë pëlqimin paraprak të tyre. Emisioni i transmetuar në këtë televizion ishte vënë në lëvizje mbi bazën e ankesës së nënës biologjike të fëmijës së birësuar. Në këtë rast, KMDP pas hetimit administrativ të zhvilluar nga Drejtoria e Hetim Inspektimit pranë këtij kontrolluesi, mbështetur në provat e grumbulluara në këtë inspektim administrativ konstatoi shkelje të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe në mbështetje të neneve 29 dhe 30 të ligjit të sipërcituar, ka urdhëruar:

- ✓ “Ndalimin e mbledhjes, grumbullimit, përpunimit dhe publikimit të mëtejshëm të të dhënave personale që lidheshin me rastin e birësimit të fëmijës me iniciale A.M shfaqur në Televizionin Kombëtar Klan”.
- ✓ “Fshirja dhe shkatërrimi i të gjitha materialeve dhe të dhënave të grumbulluara për rastin e trajtuar në emision, që lidhet me prindërit birësues dhe të birësuarin me iniciale A.M”.

Kontrolluesi TV Klan ka reaguar menjëherë duke zbatuar urdhërin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a)**. Kontrolli administrativ është përqëndruar kryesisht në kontrollin mbi marrjen e masave të përshtatshme ose jo të sigurisë nga ky operator lidhur me



mbrojtjen e të dhënave personale që mbartin faturat e konsumit të energjisë elektrike (si emri, mbiemri, nr. i kontratës, adresa, energjia e faturuar etj) për konsumatorët klientë, në procesin e shpërndarjes së faturave. Nga kontrolli administrativ rezultoi që këto fatura shpërndaheshin të pambyllura në zarfe duke bërë të mundur në këtë mënyrë aksesin e çdo kujt mbi të dhënat personale që mbanin këto fatura. Në këtë rast, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas kontrollit administrativ të zhvilluar pranë këtij kontrolluesi dhe provave relevante që rezultuan nga hetimi, në mbështetje të neneve 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" ka dalë më Rekomandim në bazë të të cilit kontrolluesi rekomandohet:

- ✓ "Të marrë masat e nevojshme teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale që mbartin faturat e konsumit të energjisë elektrike të klientëve, duke bërë mbylljen në zarf të tyre për secilin klient. Për përmbushjen e këtij detyrimi Komisioneri ka lënë një afat kohor të caktuar sipas ligjit brenda të cilit ky detyrim duhet plotësuar".

Nga kontrolluesi OSSH është përmbushur rekomandimi i Komisionerit brenda afatit, të caktuar sipas ligjit për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

**3.** Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **Autoriteti Portual Durrës ( APA sh.a)**. Kontrolli administrativ u fokusua kryesisht në kontrollin e masave që merren nga ky autoritet për sigurinë e të dhënave personale, konkretisht të dhënat personale të personave fizikë të cilët pajisen me leje hyrje ditore dhe vjetore në ambientet e Portit të Durrësit, pasagjerëve që hyjnë e dalin në këtë port me tragete të udhëtimit, subjektet fizikë më të cilët lidhen kontrata shërbimi dhe qiraje. Në këtë rast, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas kontrollit administrativ të zhvilluar pranë këtij kontrolluesi dhe provave që rezultuan nga kontrolli administrativ, në mbështetje të neneve 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" ka dalë me Rekomandim.

Shkeljet e konstatuara kishin të bënin kryesisht me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave personale dhe mospërfshirjen në rregulloret e brendshme të rregullave lidhur me konfidencialitetin për të dhënat personale sipas nenit 28 të ligjit. Për përmbushjen e këtyre detyrimeve të përcaktuara nga Komisioneri, kontrolluesit iu la një afat i caktuar kohor sipas ligjit.

Rezultoi më pas se, kontrolluesi **Autoriteti Portual Durrës ( APA sh.a)** ka zbatuar rekomandimin e Komisionerit dhe ka përmbushur detyrimet brenda afatit ligjor të caktuar.

**4.** Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit **Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit, Durrës**. Kontrolli administrativ u fokusua kryesisht në kontrollin e masave që merren nga ky kontrollues për sigurinë e të dhënave personale, konkretisht të dhënat personale të pasagjerëve që hyjnë dhe dalin në *Portin e Durrësit* dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së këtyre të

dhënave sipas qëllimit për të cilin këto të dhëna janë mbledhur, në referencë të nenit 18, 27 dhe 5 pika 1(d) të ligjit nr. 9887,dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nga KMDP pasi janë shqyrtuar aktet e kontrollit administrativ (relacioni, procesverbali i konstatimit, etj) është arritur në konkluzion se, nga kontrolluesi *Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit, Durrës* ishin marrë masat për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale konformë kushteve dhe kërkesave të ligjit nr. 9887,dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

I vetmi detyrim i papërbushur nga ana e kontrolluesit ishte detyrimi ligjor për njoftim pranë KMDP-së, për të cilin, Komisioneri në bazë të neneve 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887,dt 10.03.2008 ”Për mbrojtjen e të dhënave personale” ka dalë me Rekomandim.

Ka rezultuar gjatë monitorimit se detyrimi është përmbushur në kohë.

5. Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit ***Komisariati i Policisë Kufitare Rinas ( pranë Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Tiranë)***. Kontrolli administrativ kishte si objekt kontrollin e masave që merren nga kjo zyrë për sigurinë e të dhënave personale, konkretisht të dhënat personale të personave që hyjnë dhe dalin nga aeroporti *Rinas* dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së këtyre të dhënave sipas qëllimit për të cilin këto të dhëna janë mbledhur në referencë të nenit 18, 27 dhe 5 pika 1(d) të ligjit nr. 9887,dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në këtë rast Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas hetimit administrativ të zhvilluar pranë këtij kontrolluesi dhe provave që rezultuan prej tij, në mbështetje të neneve 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887,dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ka dalë me Rekomandim për rregullimin e shkeljeve të konstatuara. Midis të tjerash është rekomanduar hartimi i rregullores së brendshme “Për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” si dhe vendosja e tabelave paralajmëruese për përdorimin e kamerave të vëzhgimit, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 9887,dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe mbajtja e të dhënave personale brenda një afati të caktuar kohor dhe jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

Për përmbushjen e këtij detyrimi Komisioneri ka lënë një afat kohor të caktuar sipas ligjit brenda të cilit ky detyrim duhet plotësuar. Në rastin konkret ka rezultuar përmbushja e detyrimit sa i përket vendosjes së tabelave paralajmëruese për përdorimin e kamerave të vëzhgimit, kryerja e njoftimit, ndërsa akti i brendshëm rezulton të jetë në përpunim e sipër.

6. Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesve ***Qendra Shëndetësore Nr. 1 dhe Qendra Shëndetësore Nr. 2, Tiranë***. Kontrolli u fokusua kryesisht në kontrollin e masave që merren nga këto qendra për sigurimin e të dhënave të pacientëve dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së këtyre të dhënave sipas qëllimit për të cilin janë mbledhur në referencë të nenit 27, 28 dhe nenit 5 pika 1(d) të ligjit nr. 9887,dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Gjatë kontrollit rezultoi që rezultatet e analizave laboratorike nuk shpërndareshin tek pacientët të

mbyllura në zarfe. Gjithashtu, nuk kishte rregulla të qarta në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave të pacientëve në dokumentacionin që dispononte këto të dhëna.

Në këto raste Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas hetimit administrativ të zhvilluar pranë këtyre kontrolluesve dhe provave që rezultuan nga hetimi, në mbështetje të neneve 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ka dalë me dy rekomandime drejtuar Autoritetit Shëndetësor Rajonal ( ASHR) dhe Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor( ISKSH) si organe eprore të qendrave shëndetësore dhe organe kompetente në bazë të ligjit organik, për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara gjatë kontrollit administrativ. Komisioneri ka rekomanduar ISKSH:

- ✓ Të zbatohen me rigorozitet kërkesat e nenit 27 të Ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” duke vendosur mënyrat që duhet të zbatohen nga Qendrat Shëndetësore, në lidhje me zarfimin e fletëve me rezultatet e analizave laboratorike.
- ✓ Të hartohet rregullore e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, duke përcaktuar edhe afate të qarta të ruajtjes dhe administrimit të dokumentacionit që disponon të dhëna personale, sipas neneve 27 dhe 28 të ligjit.

Komisioneri ka rekomanduar ASHR:

- ✓ Të merren masat e nevojshme për krijimin e ambienteve dhe të sigurohen pajisjet e duhura për garantimin e sigurisë fizike të dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale në përputhje me nenin 27 të ligjit.

Për përmbushjen e këtyre detyrimeve Komisioneri ka lënë një afat kohor të çmuar rast pas rasti brenda të cilit këto detyrime duhen plotësuar.

Kontrolluesi, ISKSH ka përmbushur detyrimet e caktuara nga Komisioneri në rekomandim brenda afatit ligjor.

**7. Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit *Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.*** Kontrolli kishte për objekt masat që merren nga kjo zyrë për sigurinë e të dhënave personale, konkretisht të dhënat personale për personat fizikë të cilët kryejnë regjistrimin e pronave në këtë institucion dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së këtyre të dhënave sipas qëllimit për të cilin ato janë mbledhur në referencë të nenit 27 dhe nenit 5 pika 1(d) të ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në këtë rast, Komisioneri pas hetimit administrativ të zhvilluar pranë këtij kontrolluesi dhe provave relevante që rezultuan nga hetimi, në mbështetje të neneve 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008, ka dalë me Rekomandim për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, të cilat kishin të bënin me shkelje të nenit 27 dhe 28 të ligjit dhe mungesën e tabelave paralajmëruese për

përdorimin e kamerave të survejimit, në shkelje të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Për përmbushjen e këtij detyrimi Komisioneri përcaktoi një afat kohor, brenda të cilit ky detyrim duhej plotësuar.

Kontrolluesi, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë ka përmbushur rekomandimet brenda afatit të caktuar.

**8.** Është realizuar kontrolli administrativ pranë *kontrolluesit Albanian Mobile Communications sh.a (AMC)* me objekt kontrollin mbi zbatimin e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” nga operatorët e telefonisë celulare në Shqipëri në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Në përfundim të këtij kontrolli administrativ nisur nga shkeljet e konstatuara të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka urdhëruar këtë kontrollues:

- ✓ Të fshijë të dhënat personale që mbarten në skedarët (tabulatet e komunikimeve telefonike) të pajtimtarëve të cilët kanë plotësuar afatin dy vjeçar të ruajtjes, si dhe ta respektojë këtë afat në të ardhmen.
- ✓ Të shkatërrojë dosjet individuale, që mbartin të dhëna personale, të pajtimtarëve të larguar prej vitesh nga ky kontrollues, me të cilët nuk ka probleme juridike apo financiare, si dhe të respektojë këto dispozita të ligjit në të ardhmen.
- ✓ Të shkatërrojë në arshivën e tij, dosjet individuale të punonjësve, (që mbartin të dhëna personale), të cilët janë larguar prej vitesh nga ky kontrollues dhe nuk kanë probleme juridike apo financiare, si dhe të respektojë këtë detyrim ligjor në të ardhmen.

Për përmbushjen e këtyre detyrimeve Komisioneri ka lënë një afat kohor të çmuar rast pas rasti, brenda të cilit këto detyrime duhen plotësuar.

**9.** Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit *Eagle Mobile sh.a* me objekt kontrollin mbi zbatimin e ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” nga operatorët e telefonisë celulare në Shqipëri në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Në përfundim të këtij kontrolli administrativ nisur nga shkeljet e konstatuara të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka urdhëruar këtë kontrollues për:

- ✓ Pezullimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale të pajtimtarëve të tij drejt shtetit të Turqisë, deri në pajisjen me autorizim nga ana e Komisionerit, në zbatim të nenit 9 pika 1 e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;

- ✓ Informimin dhe marrjen e pëlqimit specifik të pajtimtarëve, për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale të tyre, duke e shprehur këtë qartë në kontratën e lidhur me pajtimtarët në zbatim të neneve 8 dhe 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
- ✓ Të plotësojë menjëherë njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke deklaruar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale drejt shtetit të Turqisë, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Për përmbushjen e këtyre detyrimeve Komisioneri ka lënë një afat kohor të çmuar rast pas rasti,, brenda të cilit këto detyrime duhen plotësuar.

**10.** Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit *Vodafone Albania sh.a* me objekt kontrollin mbi zbatimin e ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 ”Për mbrojtjen e të dhënave personale” nga ky operator i telefonisë celulare në Shqipëri në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Në përfundim të këtij kontrolli administrativ nuk u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

**11.** Është realizuar kontrolli administrativ pranë *kontrolluesit Coca –Cola Bottling Shqipëria sh.p.k.* Në përfundim të këtij kontrolli administrativ nisur nga shkeljet e konstatuara Komisioneri ka dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Kontrolluesi Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k të kryejë plotësisht detyrimin ligjor për njoftim pranë Komisionerit sipas nenit 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” pasi nga kontrolluesi nuk ishte deklaruar përpunimi i të dhënave biometrike të punonjësve.
- ✓ Kontrolluesi, Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k të shprehet në rregulloret e brendshme të hartuara prej tij lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin për të dhënat personale në zbatim të neneve 27/2 “c” dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave personale sipas qëllimit për të cilin këto të dhëna janë mbledhur në referencë të nenit 5 të ligjit të sipërpërmendur.
- ✓ Kontrolluesi, Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k të kryejë detyrimin ligjor për informim të punonjësve dhe subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të videosurvejimit.

Për përmbushjen e këtyre detyrimeve Komisioneri ka lënë një afat të çmuar rast pas rasti, brenda të cilit këto detyrime duhen plotësuar.

**12.** Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit *Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës*. Në përfundim të këtij kontrolli administrativ nisur nga shkeljet e konstatuara Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të neneve 5, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” , kontrolluesi të hartojë rregullore të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin ose në rregulloren ekzistuese e cila ishte në procedurë riformulimi, të përfshijë një rubrikë të veçantë, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale ku të parashikohet edhe kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave personale sipas qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar.
- ✓ Në zbatim të nenit 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Kontrolluesi kur mbledh te dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre te dhënave...” të vendosen tabela informuese në të gjitha ambientet ku janë të vendosura kamerat e vëzhgimit.
- ✓ Në zbatim të neneve 8, (Transferimi ndërkombëtar) dhe 9, (Transferimi ndërkombëtar i të dhënave që duhet të autorizohen), ky fakultet të përmbushë detyrimin, që këto transferime në rastet kur kryhen me një shtet, i cili nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave taksativisht duhet të kryhen me autorizim të Komisionerit.

Për përmbushjen e këtyre detyrimeve Komisioneri ka lënë një afat kohor të çmuar rast pas rasti, brenda të cilit këto detyrime duhen plotësuar.

**13.** Është realizuar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit *Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës*. Në përfundim të këtij kontrolli administrativ nisur nga shkeljet e konstatuara Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” brenda një afati kohor të caktuar, të plotësojë detyrimin lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- ✓ Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregullore seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008.

- ✓ Të përcaktohen rregulla të qarta në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave personale sipas qëllimit për të cilin këto të dhëna janë mbledhur në zbatim të nenit 27 pika 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008.
- ✓ Të aplikohen mënyra alternative për informimin e studentëve në lidhje me rezultatet e provimeve që zhvillohen pranë këtij Fakulteti si edhe të gjitha rezultateve të tjera të cilat mund të zbulojnë identitetin e subjekteve të të dhënave, në mënyrë që të mos shkelet privatësia.
- ✓ Në zbatim të neneve 8, 9 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” ky kontrollues të përmbushë detyrimin në lidhje me transferimet e të dhënave për studentët ose stafin akademik në shtete të tjera, që këto transferime taksativisht të kryhen me autorizim të Komisionerit në rastet kur transferimi i të dhënave personale realizohet tek një shtet i cili nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Për përmbushjen e këtyre detyrimeve Komisioneri ka lënë një afat kohor të çmuar rast pas rasti, brenda të cilit këto detyrime duhen plotësuar.

**14.** Janë nxjerrë urdhra verifikimi nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për *kontrolluesit Qendra Tregtare Univers (QTU), Casa Italia, Ford, Scan Color (JYSK)* me qëllim verifikimin e dërgimit të komunikimeve tregtare me karakter reklame (ose promocion) përmes mesazheve të tipit s.m.s, drejt numrave të ndryshëm të telefonisë celulare (AMC, Vodafon, Eagle), të subjekteve të të dhënave personale (mbajtës dhe përdorues të numrave të telefonave celularë). Mbas verifikimeve administrative të kryera pranë këtyre kontrolluesve u arrit në përfundim se dërgimi i komunikimeve tregtare me karakter reklame (ose promocion) përmes mesazheve të tipit SMS, drejt numrave të ndryshëm të telefonisë celulare (AMC, Vodafon, Eagle), të subjekteve të të dhënave personale (mbajtës dhe përdorues të numrave të telefonave celularë) nuk realizohej prej vetë këtyre kontrolluesve, por realizohej nga një kompani e tretë mbi bazën e një kontrate shërbimi. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi bazën e këtij përfundimi urdhëroi;

**15.** Kryerjen e kontrollit administrativ mbi kompaninë “**Conext**” sh.p.k. kontrollues që realizonte dërgimin e mesazheve SMS. Në përfundim të këtij kontrolli administrativ nisur nga shkeljet e konstatuara Komisioneri ka dalë me rekomandim sipas të cilit:

- ✓ Kontrolluesi “**Connext**” sh.p.k në zbatim të nenit 6 pika 1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, në të ardhmen të mos kryejë dërgimin e komunikimeve tregtare me karakter reklame (ose promocion) përmes mesazheve të tipit SMS, drejt numrave të ndryshëm të telefonisë celulare të subjekteve të të dhënave (abonentë të kompanive AMC, Vodafon, Eagle ), pa marrë pëlqimin paraprak të tyre për ofrimin e një shërbimi të tillë.

Aktualisht për të gjithë kontrollat e ushtruara në kontrolluesit e mësipërm për të cilët janë dhënë rekomandime duke përcaktuar edhe afate kohore për plotësimin e tyre, jemi në procesin e monitorimit, pasi janë kryer gjatë tre muajve të fundit të vitit.

## **V.II Vendimet administrative (gjobat) e vendosura nga KMDP**

KMDP për vitin 2010 nuk ka pasur prioritet aplikimin e sanksioneve administrative (gjobave). Në vlerësimin e saj aplikimi i këtyre sanksioneve administrative nuk është mjeti me të cilin institucioni do të afirmohej dhe do të bënte të zbatueshëm përballë kontrolluesve publikë dhe privatë ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.”

KMDP ka pasur parasysh orientimet e ekspertëve ndërkombëtarë që kanë asistuar pranë nesh dhe që vazhdimisht janë shprehur dhe kanë insistuar se nuk është qëllim në vetvete për zyrën e Komisionerit vendosja e sanksioneve (gjobave) ndaj kontrolluesve. Ata i japin një rëndësi të veçantë ndërgjegjësimit, sensibilizimit dhe rritjes së shkallës së bashkëpunimit midis KMDP-së dhe kontrolluesve me qëllim implementimin dhe bërjen sa më të zbatueshëm të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.”

Megjithatë, KMDP për vitin 2010 ka vendosur dënimin me gjobë për 13 (trembëdhjetë) kontrollues të ndryshëm publikë dhe privatë, të cilët kanë qenë në shkelje të përsëritura dhe të qëllimshme të ligjit, në lidhje me përmbushjen e detyrimit ligjor për njoftim pranë Komisionerit sipas nenit 21 të ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Kontrolluesit ndaj të cilëve është vendosur dënimi me gjobë janë: Universiteti “Vitrina” Tiranë; Shkolla e Lartë Amerikane Tiranë; Qendra tregtare “City Park”, Tiranë; Qendra Diagnostikuese “Moskat” Tiranë; Posta Shqiptare; Klinika “Nora Med” Tiranë; Qendra Diagnostike “Medi-Care”, Tiranë; Grand hotel Tiranë; Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë; Shkolla jo publike parauniversitare “Anglo –Shqiptare/Fenix” Tiranë; Shkolla jo publike universitare “Rreze drite” Tiranë; Shkolla jo publike parauniversitare “ Mësonjëtorja XXI” Tiranë.

Të gjithë këta kontrollues pas inspektimeve të kryera kanë rezultuar në shkelje ligjore paraprakisht të natyrës rekomanduese por për shkak të konstatimit të mos kryerjes nga ana e tyre të njoftimit përkatës si detyrim ligjor që duhet përmbushur në zbatim të nenit 21 të ligjit megjithëse janë njoftuar për këtë detyrim me shkresa të përsëritura, është vendosur sanksioni ligjor i dënimit me gjobë.

Nga këto kontrollues vetëm Shkolla jo publike parauniversitare “Anglo –Shqiptare/Fenix” Tiranë ka ekzekutuar vullnetarisht vendimin e gjobës së vendosur nga Komisioneri.



Kontrolluesit e tjerë për të cilët është vendosur sanksioni i gjobës nuk kanë paguar në favor të buxhetit të shtetit këtë gjobë dhe KMDP është në ndjekje të procedurave për ekzekutim të detyrueshëm të gjobave pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Zyrës së Përmbarrimit.

## VI. Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare

- ✓ Konferenca e pranverës e mbajtur në Pragë nga 19 deri në 20 prill 2010 analizoi në detaje bashkëpunimin mbi temën e saj “ Pesho mbi të kaluarën, duke menduar të ardhmen”. Prezenca jonë midis krerëve më të lartë të Institucioneve për Mbrojtjen e të dhënave të vendeve të Bashkimit Evropian, pati një rëndësi të veçantë, pasi përveç shkëmbimit të eksperiencës, mbledhja e Komitetit të Akreditimit, me një vendim të përbashkët vendosi Akreditimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri si anëtar me të drejtë vote të kësaj konference.
- ✓ Në vijim të angazhimeve ndërkombëtare, në kuadrin e të drejtave dhe detyrimeve si dhe kompetencave që ka institucioni për mbikqyrjen e përpunimit të të dhënave në sektorin policor, jemi përfaqësuar në takimin e Grupit Ad-Hoc të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 24-26 Shkurt 2010, Ljubljana, Slloveni.

Ky grup pune, në përbërje të të cilit janë përfaqësues të policive respektive dhe të autoriteteve mbikqyrëse të të dhënave personale nga vendet e Evropës Jug-Lindore, ka për kompetencë monitorimin e zbatimit të “Konventës për Bashkëpunimin Policor në vendet e Evropës Jug-Lindore”, ku Republika e Shqipërisë është palë, ratifikuar me Ligjin Nr. 9604, datë 11.9.2006. Qëllimi dhe koha e veprimtarisë së këtij grupi është e përcaktuar, si dhe menaxhohet nga rregulla dhe procedura të detyrueshme. Qëllimi i këtij grupi pune është të realizojë vlerësimin për efikasitetin e bashkëpunimit policor dhe nivelin e mbrojtjes së të dhënave që do të çojë në shkëmbimin e ADN-së ndërmjet vendeve anëtare, si dhe të realizojë monitorim dhe mbikqyrje në vendet anëtare të konventës.

Anëtarët e tij mund të vendosin të inspektojnë një vend palë për të verifikuar në vend sesi zbatohen dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, por pasi të shprehet çdo shtet zyrtarisht, nëpërmjet Ministrit të Brendshëm, që është i gatshëm për të pritur ekspertët vlerësues. Shqipëria ishte vendi i parë, i cili nëpërmjet Ministrit të Brendshëm paraqiti “*deklaratën e gatishmërisë*” për vlerësimin në terren të përpunimit të të dhënave personale në fushën policore. Procesi i vlerësimit është përcaktuar të zhvillohet në datat 22-25 mars 2011 pranë Zyrës së Komisionerit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Paraprakisht dhe mbi të cilin do të zhvillohen edhe vlerësimet në terren, u plotësua dhe u paraqit një pyetësor standart, i cili do të analizohet nga vendet vlerësuese (vendet anëtare të konventës).

- ✓ Po ashtu, në mbledhjen plenare të radhës së Komitetit Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale (T-PD), të Këshillit të Evropës, nga data 01-04 qershor, në Strasburg të Francës, përfaqësimi ynë me të drejtë vote na obligoi në përkushtim, në diskutime por edhe në pasqyrime të nivelit tonë institucional dhe ligjor që nga ngritja e autoritetit e në vazhdim.

Sipas rendit të axhendës së përcaktuar ky Komitet i zhvilloi punimet e tij në katër ditë intensive nëpërmjet diskutimeve, debateve, pyetjeve dhe vendimeve të vendeve anëtare të këshillit të Evropës. Nëpërmjet prezantimit të kandidaturave, komiteti votoi dhe përzgjodhi Kryetarin e ri të Komitetit T-PD, Dy nënkryetarët e rinj të Komitetit, si dhe Anëtarët e rinj të Byrosë së këtij Komiteti.

Komiteti miratoi Projekt-Rekomandimin “Mbi Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, në lidhje me Profilizimin”. Ky rekomandim, pas diskutimeve në instancat e tjera të KE-së, u miratua nga Komiteti i Ministrave më datë 23 Nëntor 2010 (CM/Rec(2010)13).

Së fundmi dhe jo më pak e rëndësishme, Komiteti zhvilloi diskutime mbi zhvillimet më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së të dhënave në vendet anëtare, ku Zyra jonë shtjelloi një prezantim mbi ecurinë e veprimtarisë që nga mbledhja e fundit e këtij Komiteti në Shtator të vitit 2009. Informacioni i detajuar i veprimtarisë i është përcjellë Sekretariatit të T-PD, i cili e publikoi atë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Evropës.

- ✓ Konferenca e Organizatës për bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) në tetor në Jerusalem korrespondonte me 30 vjetorin e nxjerrjes së udhëzimeve të OECD mbi rolin e individit mbi mbrojtjen e privatësisë dhe fluksin e të dhënave ndërkufitare. Udhëzimet e miratuara në vitin 1980 ishin deklaratat e para ndërkombëtare të parimeve bazë të privatësisë. Ky organizim mblodhi një numër të konsiderueshëm përfaqësuesish mes të cilëve edhe ne.

Pjesëmarrja jonë në Konferencën ndërkombëtare të 32-të të mbrojtjes së të dhënave dhe Komisionerëve të Privatësisë sërish ishte mjaft e rëndësishme për faktin e paraqitjes në të, të kërkesës për akreditim. Pas diskutimeve të krerëve më të lartë me eksperiencë dhe njohje të gjerë në fushën e mbrojtjes së të dhënave lidhur me temën “Brezat e privatësisë” vënë në fokus të këtij organizimi dhe diskutimit të raportit të nëntë vjetor të Komitetit të Akreditimit për Konferencën ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Komisionerëve të Privatësisë u shenjua akreditimi i institucionit tonë me të drejtë vote. Prania jonë në të ardhmen me këtë atribut u arrit si në të gjithë akreditimet e tjera mbi vlerësimet e bëra të punës intensive të pasqyruar nga autoriteti ynë, dëshirës dhe konkretizimit të veprimeve

integruese me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut si subjekti më i rëndësishëm i të dhënave personale.

- ✓ Konferenca e autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Frankofonisë e organizuar në Paris, Francë, në nëntor ndau eksperiencat kombëtare të autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave, diskutoi gjerësisht mbi krijimin e një instrumenti ndërkombëtar në këtë fushë në funksion të të cilës u miratua edhe një rezolutë. Pjesëmarrja jonë reflektoi avancimin e autoritetit, shprehu opinione, përthithi eksperiencën e praktikën më të mira e gjithshka tjetër të rëndësishme.
- ✓ Marrëdhëniet e ngushta me ndërkombëtarët, megjithëse ende nuk jemi bërë shtet anëtar i BE-së, akreditimet e shumta në një kohë relativisht të shkurtër të funksionimit të institucionit tonë, kanë synuar gjithashtu, shkëmbimin e eksperiencave, njohjen me të gjithë dokumentët e rëndësishëm që miratohen nga organizmat e BE-së, përfshirë rekomandime apo materiale shpjeguese me argumentin e vetëm e të qartë për të arritur intensivisht familjen e madhe evropiane dhe për ti paraprirë çdo zhvillimi ligjor.

Më poshtë janë përmendur, informacione, opinione, rekomandime të njoftuara të cilat hera herës janë publikuar në faqen tonë zyrtare për të orientuar Kontrolluesin e të dhënave si dhe subjektet e të dhënave lidhur me mbrojtjen e të drejtave të tyre, dhe që në disa raste për to janë dhënë edhe mendime si akte të hapura për mendim apo janë marrë si referencë për të përgatitur udhëzime për punën e kontrolluesve.

#### *Materiale të njoftuara nga WPPJ 29 (Grupi i Punës për Policinë dhe Drejtësinë)*

- Opinioni mbi të ardhmen e Grupit të Punës nga Autoriteti për Mbrojtjen e të Dhënave Sviceriane.
- Informacion i dhënë nga delegacionet për situatën kombëtare (duke përfshirë dhe takimet e WP (Grupit të Punës)).
- Informacion mbi fushat prioritare për punën e ardhshme nga WP (grupi i punës), bazuar në “Planin e veprimit” të Komisionit Europian.
- Plani i veprimit- gjërat prioritare për analizë nga WP (grupi i punës).
- Informacion i dërguar nga WP (grupi i punës) për marrëveshjen ndërmjet BE dhe SHBA për mbrojtjen e të dhënave personale kur transferohen dhe përpunohen të dhëna me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të veprave penale.
- Janë dërguar procesverbalet mbi minutat e takimit të realizuara gjatë mbledhjes së WPPJ (Grupi i punës për Policinë dhe Drejtësinë)

***Materiale të njoftuara nga Byroja e Komitetit Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje përpunimin automatik të të dhënave personale.***

- Studim mbi Rekomandimi nr. 89 për mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura për qëllime punësimi dhe për të sugjeruar propozimet për rishikimin e Rekomandimit të mësipërme. (Të punuara nga Giovanni Buttarelli).
- Komunikatë nga Komisioni Europian për Parlamentin, Këshillin, Komitetin Ekonomik e Social dhe Komitetit të Rajoneve për një qasje gjithë përfshirëse për mbrojtjen e të dhënave në BE.
- Rekomandimi i 13 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik e të dhënave personale në kontekstin e profilizimit.
- Modifikimi i nenit 4 të rregullave dhe procedurave të brendshme të T-PD përgatitur nga Byroja e Komitetit Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale.
- Rregullat dhe procedurat e Komitetit Konsultativ të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale.
- Përmbledhje paraprake e transferimit të ADN dhe bazave të të dhënave, përgjigjet e dërguara nga: Estonia, Bullgaria, Qipro, Republika Çeke, Hungaria, Irlanda, Malta dhe Zvicra.

***Materiale të miratuara gjatë Konferencën Evropiane të Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zhvilluar në Pragë në datat 29, 30 Prill.***

- Rezoluta mbi përdorimin e skanerave trupore për qëllimin e sigurisë së aeroporteve.
- Rezoluta për zhvillimin e ardhshëm të të dhënave personale.
- Rekomandimet në Implementimin e Konventës 185/2001 “Të Krimit Kompjuterik të Këshillit të Evropës”.
- Rezoluta mbi ngritjen e veprimeve të përbashkëta për vënien në dijeni dhe edukimin e të rinjve në nivelin Evropian dhe Ndërkombëtar.
- Grupi i Punës mbi Policinë dhe Drejtësinë- Projekt Raport Vjetor për vitin 2009.
- Vendim paraqitur nga Grupi i Punës mbi Policinë dhe Drejtësinë “Mbi implementimin e një politike mbikqyrëse Evropiane”.

## **VI.I Bashkëpunimi me Komisionin Evropian, kontrata e Projektit EU-IPA 2009**

Në kuadër të bashkëpunimit me autoritetet e Komisionit Evropian, në nëntor të vitit 2010 ka nisur implementimi i projektit EU-IPA 2009 “Përforcimi Institucional i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Në përputhje me kontratën e projektit është krijuar Komiteti Drejtues i projektit i cili do të funksionojë gjatë periudhës 18 mujore të implementimit

të tij. Ekspertët e huaj do të japin asistencën e tyre komunitare në mënyrë që të realizohet zbatimi dhe sigurimi i këtij projekti, duke ndihmuar në rritjen e njohurive mbi përvojat e vendeve të BE-së si dhe në përmirësimin e profesionalizmit të stafit të institucionit. Në këtë drejtim KMDP ka bashkëpunuar për përmbushjen e të gjithë kërkesave të adresuara nga ekspertët, ka evidentuar pjesëmarrjen në mbledhjen e parë të Komitetit Drejtues si dhe ka paraqitur mendimet lidhur me projekt raportin e parë të zbatimit të tij.

## VI.II Asistenca e ekspertëve ndërkombëtarë

Në tetor 2010 Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri firmosi urdhërin administrativ nr.1 duke përcaktuar datën 8 nëntor 2010 si datë të takimit “kick off” me palët e përfshira në projekt DBE-Autoriteti Kontraktues, FIIAPP-Konsulenti dhe Përfituesi-KMDP, dhe njëkohësisht si datë për fillimin e implementimit të projektit IPA 2009 “Përforcimi Institucional i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” në Shqipëri. Ky projekt përbëhet nga katër komponentë;

1. Kuadri ligjor.
2. Proceset operuese.
3. Trajnimi i stafit.
4. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit.

Paraprakisht, është paraqitur raporti fillestar nga kompania konsulenti FIIAPP dhe mbas vërejtjeve të bëra nga Komiteti Drejtues është miratuar nga Delegacioni i BE ne Tiranë. Faza aktuale e tij është marrja e asistencës nga ekspertët e huaj për kuadrin ligjor; aktet ligjore e nënligjore, amendamentet, udhëzimet dhe rregulloret. Jemi në bashkëpunim të mirë me të gjithë institucionet që ky projekt përfshin si: MIE, MB, MD, MITIK, MASH, MSH, AKSHI etj.

## VII. Realizimi i buxhetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KMDP në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektësi në zbatim të ligjit nr. 10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2010” i ndryshuar, udhëzimit nr.1 datë 21.01.2010, “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010” si dhe ka përgatitur buxhetin aftat mesëm 2011-2013.

Fondi i Përgjithshëm buxhetor akorduar për vitin 2010, paraqitet me treguesit e mëposhtëm:

Në mijë lek

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi(%)

*KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE*

1	Paga Personeli	26913	24031	2882	89
2	Sigurime shoqërore e shëndetësore	4000	3560	440	89
3	Materiale e shërbime të përgjithshme	9749	9565	184	98
4	Kuotizacione	28	28	-	100
5	Transferime ne buxhete familjare	450	415	35	92
6	Investime	7000	5785	1215	83
	<b>TOTALI</b>	<b>48140</b>	<b>43384</b>	<b>4756</b>	<b>90</b>

- ✓ Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit për paga dhe sigurime shoqërore përputhej me kërkesën e mjaftueshme për të mbuluar nevojat e institucionit, sipas strukturës organike. Mos realizimi në masën prej 11% ka ardhur si rezultat i mos trajtimit me pagë të pozicionit të këshilltarit (për pasojë të trajtimit me pension të posaçëm si anëtar i gjykatës së Lartë), si dhe mos përdorimit të fondit të veçantë, për rezultatet individuale në punë, të nëpunësve civilë si pasojë e zbatimit të V.K.M nr. 929, datë 17.11.2010.
- ✓ Në realizimin e shpenzimeve buxhetore operative “Materiale e shërbime të përgjithshme” në masën 98 %”, KMDP është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, në përmbushje të strategjisë, objektivave, aktiviteteve e prioriteteve në menaxhimin me efektivitet të fondeve të akorduara nëpërmjet plotësimit të dokumentacionit ligjor për likuidim, brenda afateve kohore për zbatim të kontratave të lidhura ndërmjet palëve.
- ✓ Në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, në mbështetje të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me VKM nr. 135, datë 03.02.2008, dhe nr. 392, datë 08.04.2008 dhe të planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2010, për këtë periudhë, janë realizuar tre procedura tenderimi me objekt “Orendi për zyra”, “Blerje pajisje kompjuterike”, “Rikonstruksion i ambienteve të brendshme të zyrave të KMDP”.

Për fondet e investimeve të akorduara, mos realizimi në masën 17 % ka ardhur si rezultat i kursimit gjatë ndjekjes së procedurave të prokurimit. Realizimi i të ardhurave të KMDP për vitin 2010 në masën prej 30.000 lekë, ka ardhur si rezultat i gjobës së vendosur për subjektin shkolla jo publike “Anglo Shqiptare/Fenix”, për mos zbatim korrekt të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” derdhur në buxhetin e shtetit.

Në vijim synohet të zbatohen me korrektësi treguesit e buxhetit të planifikuar për KMDP duke synuar maksimizimin e efektivitetit të përdorimit të shpenzimeve të akorduara në funksion të realizimit të strategjisë së miratuar për vitin 2011.

### **VIII. Sektori i Teknologjisë së Informacionit**

- ✓ Gjatë Vitit 2010, Sektori i Teknologjisë së Informacionit është angazhuar në veprimtari të ndryshme bazuar në nevojat dhe rregulloren e brendshme të Institucionit. Specialistët e IT-së janë angazhuar në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike duke organizuar seminare në lidhje me përdorimin e pajisjeve kompjuterike, lundrimin e sigurt në internet, njohjen e punonjësve të Zyrës së Komisionerit me rreziqet e mundshme të cilat mund të hasen gjatë lundrimit në internet apo përdorimin e pajisjeve komunikuese të lëvizshme (P.sh USB FlashDrive), si dhe trajnimin për një përdorim të kujdesshëm dhe të sigurt të pajisjeve elektronike, etj.
- ✓ Është bërë asistencë, është kolauduar dhe vënë në funksionim me sukses Regjistri i Njoftimeve për subjektet kontrollues të cilët operojnë në Republikën e Shqipërisë. Me anë të këtij aplikacioni të aksesueshëm on-line nëpërmjet faqes zyrtare të Internetit realizohet njoftimi për përpunimin e të dhënave nga kontrolluesit, menaxhimi i këtij informacioni nga specialistët e Drejtorisë së Regjistrimit si dhe regjistrimi e publikimi në Regjistrin Elektronik të Subjekteve Kontrollues në faqen zyrtare **www.kmdp.al**.
- ✓ Është riformuluar faqja zyrtare e Institucionit dhe është plotësuar gradualisht me informacione të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin e KMDP-së si dhe të fushës që institucioni ynë mbulon. Faqja zyrtare përditësohet të paktën një herë në javë dhe në varësi të veprimtarisë apo njoftimeve të ndryshme që vijnë nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun.
- ✓ Po kështu, nga ana e Sektorit IT është marrë pjesë në tenderimin e pajisjeve logjistike si kompjuterë, printerë, serverë dhe UPS duke përgatitur dokumentacionin përkatës në bazë të specifikimeve teknike (këto të bazuara në nevojat e Institucionit), duke zhvilluar procedurat vlerësuese të ofertuesve si dhe është bërë kolaudimi i pajisjeve të ofruara nga fituesi.
- ✓ Sektori i Teknologjisë së Informacionit është aktivizuar me pjesëmarrje në disa konferenca dhe prezantime të teknologjive më të fundit të informacionit apo politikave të reja të cilat ndiqen nga Ministria e Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit.

### **IX. Synimet kryesore të punës dhe Strategjia për vitin 2011**

Vizioni i Strategjisë të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011 është avancimi në drejtim të zhvillimit të kuadrit ligjor (përfshirë këtu qasjen me aktet ndërkombëtare dhe qasjen e legjislacionit të brendshëm me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale), në drejtim të ndërgjegjësimit tërësor të subjekteve të të dhënave personale. Si një nga objektivat

kryesor dhe të vazhdueshëm të Zyrës së Komisionerit për vitin 2011 do të jetë kontrolli i zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë që të shmangët ose të parandalohet vullnetarisht përpunimi i paligjshëm ose i pasaktë i të dhënave personale, qoftë ky i pjesshëm apo i plotë.

Bashkëpunimi institucional për zbatimin e plotë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale do të ndihmojë në dhënien e më shumë mendimeve për akte ligjore e nënligjore në këtë fushë, në përmirësimin e praktikës më të mirë të tij, në dhënien e drejtësisë në këtë fushë si dhe në zbatimin e tij në praktikë. Marrëveshjet e bashkëpunimit do të angazhojnë institucionet palë, të punojnë mbi parimin e reciprocitetit për të asistuar, bashkëpunuar, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në vitin 2011, KMDP do të vijojë në mënyrë më intensive për përmbushjen e detyrimit për të njoftuar duke synuar dyfishimin e numrit të njoftimeve të vitit 2010, në radhë të parë duke synuar komunikim të vazhdueshëm me kontrolluesit në të gjithë sektorët, por veçanërisht në ato sektor apo fusha ku numri i njoftimeve ka qenë më i ulët, si dhe në ato fusha ku risku i cënimit të privatësisë dhe i të dhënave personale mendohet të jetë më i lartë. Së dyti, KMDP do të ketë sërish prioritet të saj in nxitjen e mëtejshme të bashkëpunimit institucional me ato institucione shtetërore apo private që konsiderohen institucione kyç në procesin e rritjes së ndërgjegjësimit të kontrolluesve për përmbushjen e këtij detyrimi.


Mbetet prioritet kontrolli, rritja e numrit të inspektimeve për sa i përket cilësisë së përpunimit dhe sigurisë të të dhënave personale.

Rëndësi të veçantë do ti jepet ndërtimit të rrjetit të brendshëm kompjuterik (Intranetit) i cili do të shërbejë për lehtësimin dhe mbarëvajtjen e punës të KMDP.


Pas ngritjes së bibliotekës, KMDP do të vazhdojë pasurimin e saj me punime, botime dhe përkthime nga praktikat ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me tema të ndryshme (përfshirë abonimet në botimet ligjore dhe revistat ndërkombëtare për të marrë informacionin më të fundit për çështje që lidhen me mbrojtjen e të dhënave).



VIII. Të dhëna statistikore mbi veprimtarinë e KMDP




- ✓ Kuadri Ligjor për vitin 2010




- ✓ Kërkesa për transferim të dhënash personale për vitin 2010







- ✓ Sensibilizimi dhe njohja me Ligjin Nr.9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” për Vitin 2010



✓ Pyetësor mbi njohjen me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale





✓ Rezultatet e pyetësorit të zhvilluar me nxënësit e shkollave nëntë-vjeçare




✓ Njoftimet e Përgjithshme

	Institucione publike								Institucione private			Organizata Jofitimprurëse
	Institucione qendrore			Institucione të Pushtetit Vendor					Sh. a	Sh. p. k	Person fizik	
	Ministri të linjës	Institucione të pavarura	Institucione të varësisë	Bashki	Minibashki	Qarqe	Komuna	Prefektura				
<b>Njoftime</b>	7	4	287	56	10	3	27	5	135	651	7	7
<b>TOTALI</b>	298			101					793			7
	<b>1199</b>											



	Institucione publike								Institucione private			Organizat e Jo-fitimprurëse
	Institucione qendrore			Institucione te Pushtetit Vendor					Sh. A.	Sh. P. k	Pers on fizik	
	Minist ri te linjës	Instituci one te pavarur a	Instituci one te varësisë	Bash ki	Mini Bas hki	Qar qe	Komu na	Prefekt ura				
<b>Njoftime</b>	5	4	243	41	7	1	19	4	134	542	6	6
<b>TOTALI</b>	252			72					682			6
	1012											


✓ Subjekte të Regjistruara



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

	FUSHAT																									
	Arsimi					Shëndetësia				Tregtia							Shërbi me Financiare		Shërbi me Ligjore			Telekomunikacion				
	Parashkollo	Shkolla 9-	Shkolla te	Universitete	Kolegje	Institute	Spitale	Klinika	Oendra	Institute te	Farmaceuti	Shoqeri	Sherbime	Sherbime	Loira Fati	Ndertim	Menaxhim i	Shoqeri	Transport	Banka	Intitucione	Studio	Avokati	Noteri	Komunikim i Elektronik	Komuniki m Postar
<b>Subjekt et e regjistruara</b>	0	1	8	2	1	5	6	1	2	0	4	5	9	2	3	2	1	1	7	1	8	4	1	0	9	2
<b>TOTALI</b>	<b>49</b>					<b>22</b>				<b>590</b>							<b>23</b>		<b>5</b>			<b>11</b>				
	<b>700</b>																									

✓ Përqindja e Regjistrimit sipas Fushave



✓ Tabela e menaxhimit të Procesit të Njoftim-Regjistrimit

Numri i shkresave	Sektori publik	Sektori privat
		1044
<b>TOTALI</b>	<b>5867</b>	



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

LLOJI I AKTIVITETIT	Nr.
Informacion plotësues të kërkuar	675
Informacion i plotë të ardhura me shkresa, e-maile, tel.	449
Përqindja e informacionit të ardhur brenda afatit	71.5 %
Përqindja e informacionit të ardhur jashtë afatit	17.25 %
Përqindja e informacionit të paplotësuar	11.25 %
Telefonata për sqarim	1480
Pritje të subjekteve për sqarim	230
Raste që kemi kërkuar që subjekti të paraqes kërkesë për transferim ndërkombëtar në vende pa nivel	3
Raste të dyshuara për cënim të privatëise dhe të dhënave personale-informacion për Drejtorinë e Hetim-Inspektimit për verifikim dhe procedura të tjera ligjore	10

Konc: M.Dedaj, E.Karagjozi, M.Hila, A.Shala, L.Morina, I.Pira

Tiranë më 21.02.2011